



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje në lidhje me To

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Nina Tavakoli
Sofi Menegon

Mbrojtësit kujdestar të Bashkim Smakajt
Bas Martens

Zyrës Administrative
Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe
Mbështetjen e Dëshmitarëve

Mbrojtësit të Specializuar të Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtësit kujdestar të Fadil Fazliut
Mihil Pestman

Mbrojtësit kujdestar të Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

I.	HISTORIKU PROCEDURAL.....	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE.....	4
III.	DISKUTIM.....	8
A.	Parimet për nxjerrjen e provave.....	8
1.	Hyrje	8
2.	Roli i palëve dhe i Zyrës Administrative	9
3.	Komunikimi i provave Gjykatës së Procedurës Paraprake	10
4.	Afatet për nxjerrjen e materialeve	11
5.	Plotësia dhe relevanca e provave të nxjerra.....	12
B.	Afatet për nxjerrjen e provave.....	13
1.	Rregulla 102(1)(a): materialet mbështetëse të Aktakuzës.....	13
2.	Rregulla 102(1)(b): Materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim	14
3.	Rregulla 102(3): Provat juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të marra nga të akuzuarit ose që i përkasin atyre	19
4.	Rregulla 103: Provat shfajësuese	24
5.	Rregulla 107: Materiali i mbrojtur	26
C.	Nxjerrja e provave nga Mbrojtja	27
D.	Përkthimi i dokumenteve dhe provave	28
E.	Procedura për nxjerrjen e provave	30
F.	Kufizimet për nxjerrjen e informacionit	34
1.	Parimet e përgjithshme	34
2.	Standardi ligjor.....	35
3.	Sistemi i redaktimit.....	36
4.	Redaktimet standarde	40
(a)	Redaktimet sipas rregullës 108(1)(a) të Rregullores:	42
(b)	Redaktimet sipas nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullave 80(4)(a)(i)-(ii) dhe 108(1)(b)-(c) të Rregullores:	43
(c)	Informacion tjetër që nuk është objekt i nxjerrjes së informacionit në pajtim me Rregulloren:.....	44
5.	Redaktimet jostandarde	45
IV.	VENDIM	46

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 95(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi pjesërisht Aktakuzën kundër Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Bashkim Smakajt ("z. Smakaj"), Isni Kilajt ("z. Kilaj"), Fadil Fazliut ("z. Fazliu") dhe Hajredin Kuçit ("z. Kuçi") (së bashku "të akuzuarit").²
2. Më 2 dhjetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi aktakuzën e konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar").³
3. Më 10 dhjetor 2024, pas paraqitjes së parë të të akuzuarve para Gjykatësës së Procedurës Paraprake,⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake caktoi konferencën e parë

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial.

³ KSC-BC-2023-12, F00040, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 2 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale, e cila përmban Aktakuzën e Konfirmuar. Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 6 dhjetor 2024, [F00055/A01](#).

⁴ KSC-BC-2023-12, F00059, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 dhjetor 2024, publik; F00063, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Ricaktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Isni Kilajt*, 7 dhjetor 2024, publik. **Shih gjithashtu Z. Thaçi**: F00048, Administratorja, *Njoftim mbi Dorëzimin e Fletarrestimit për Hashim Thaçin sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, konfidencial; F00064, Administratorja, *Raport mbi Dorëzimin e Fletarrestimit për Hashim Thaçin*, 7 dhjetor 2024, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, konfidencial dhe *ex parte*; **z. Smakaj**: F00042, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Bashkim Smakajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, konfidencial; F00058, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Bashkim Smakajt në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; **z. Kilaj**: F00043, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Isni Kilajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, konfidencial; F00056, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Isni Kilajt në Objektivin e*

mbi ecurinë e kësaj çështjeje – që u caktua të mbahej më 17 dhjetor 2024 – me qëllim shqyrtimin e ecurisë së çështjes dhe organizimin e nxjerrjes së materialeve mes palëve. Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi palët dhe Zyrën Administrative që të bënin paraprakisht parashtrime me shkrim në lidhje me aspekte të ndryshme të ecurisë së hetimeve, provave që do të paraqisnin në gjykim, si dhe procesit të nxjerrjes së materialeve.⁵

4. Më 12 dhe 13 dhjetor 2024, ZPS-ja,⁶ Zyra Administrative,⁷ Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”)⁸ dhe Mbrojtja e z. Kilaj (“Mbrojtja e Kilajt”)⁹ dorëzuan parashtrime me shkrim. Mbrojtja e z. Smakaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi nuk dorëzuan parashtrime me shkrim (“Mbrojtja e Smakajt”, “Mbrojtja e Fazliut” dhe “Mbrojtja e Kuçit”) (së bashku “Mbrojtja”).

Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; **z. Fazliu**: F00045, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Fadil Fazliut sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, konfidencial; F00057, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Fadil Fazliut në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; **z. Kuçi**: F00046, Administratorja, *Njoftim i Dorëzimit të Fletëthirrjes për t'u Paraqitur Hajredin Kuçit*, 5 dhjetor 2024, konfidencial; F00068, Administratorja, *Raport për Dorëzimin Hajredin Kuçit Njoftimin për Paraqitje*, 8 dhjetor 2024, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2023-12, F00072, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Order Setting the Date for the First Status Conference and for Submissions](#) (Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime) (“Urdhri për Parashtrime”), 10 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, publike.

⁶ KSC-BC-2023-12, F00079, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 12 dhjetor 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 dhjetor 2024, F00079/RED.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00078, Zyra Administrative, *Parashtrime para Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes në zbatim të Urdhrit F00072*, 12 dhjetor 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00082, Mbrojtja e Thaçit, *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit për Konferencën e Parë për Ecurinë e Çështjes* (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit”), 13 dhjetor 2024, konfidenciale.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00083, Mbrojtja e Kilajt, *Parashtrime të Mbrojtjes së Kilajt për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes* (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt”), 13 dhjetor 2024, konfidenciale.

5. Më 17 dhjetor 2024, u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes, ku palët dhe Zyra Administrative bënë parashtrime (të mëtejshme) me gojë dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi disa urdhra gojorë.¹⁰

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në posedim të ZPS-së që janë në favor apo kundër të akuzuarit i vihen atij në dispozicion para fillimit të procesit dhe gjatë procedurave, objekt vetëm i kufizimeve që janë rreptësisht të domosdoshme dhe kur zbatohen masa të domosdoshme mbrojtëse balancuese.

7. Në bazë të rregullës 46(1) të Rregullores, dhe në varësi të detyrimeve të Administratorit përcaktuar në rregullën 24 të Rregullores, ZPS-ja është përgjegjëse për mbajtjen, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit dhe materialit fizik dhe elektronik të mbledhur gjatë hetimeve të veta.

8. Në bazë të rregullës 95(2)(b) të Rregullores, pas paraqitjes së parë të të akuzuarve sipas rregullës 92 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton afatet për nxjerrjen e provave, merr masa për të mundësuar nxjerrjen e materialeve në kohë, dhe përgatit një raport për trupin gjykues, mbi nxjerrjen e materialeve.

9. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit ndër të tjera, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; dhe (ii) ndërmarrjen e hapave që

¹⁰ KSC-BC-2023-12, Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes ("Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes"), 17 dhjetor 2024, publik, f. 126-198.

mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

10. Në bazë të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 105, 106, 107, dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe të paktën 30 ditë nga paraqitja e parë e të akuzuarit, materialet mbështetëse të aktakuzës të dorëzuar për konfirmim, si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit.

11. Në bazë të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, brenda afateve të caktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë para nisjes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, këto materiale: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që ZPS-ja e ka ndërmend t'i ftojë të dëshmojnë në gjykim, në gjuhën të cilën i Akuzuari e kupton dhe e flet; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet ose transkriptet që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

12. Në bazë të rregullës 102(2) dhe (4) të Rregullores, deklaratat e dëshmitarëve shtesë të ZPS-së, të cilat nuk i janë bërë të njohura Mbrojtjes brenda afatit prej 30 ditësh përpara nisjes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjyq, i bëhen të njohura Mbrojtjes sa më shpejt që të jetë e mundshme, në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet, së bashku me arsyet për vonesën e nxjerrjes së materialit. Çdo material i nxjerrë në këtë mënyrë finalizohet gjatë fazës së procedurës paraprake.

13. Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, me kërkesë të Mbrojtjes dhe pa vonesë, ZPS-ja vë në dispozicion çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e ZPS-së, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit.

14. Në bazë të rregullës 103 të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë në provat e ZPS-së, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike.

15. Në bazë të nenit 23(1) të Ligjit, rregullat 80(1) dhe 108(1)(b) të Rregullores, një panel mund të urdhërojë, *proprio motu* ose në bazë të një kërkesë, masa të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dëshmitarëve.

16. Në bazë të rregullës 80(4)(a)(i)-(iii), (d), dhe (e) të Rregullores, këto masa mund të përfshijnë fshirjen e emrave dhe të dhënave identifikuese me qëllim parandalimin e nxjerrjes për të akuzuarin dhe/ose publikun, në rast se është e domosdoshme, të identitetit dhe/ose vendndodhjes së një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në proces gjyqësor ose të një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër me dëshmitarin ose viktimën.

17. Në bazë të rregullës 107(2) të Rregullores, ZPS-ja i bën kërkesë panelit për t'u liruar, tërësisht ose pjesërisht, nga detyrimi sipas rregullës 102 dhe rregullës 103 për nxjerrjen e materialit fillestar në qoftë se informacioni që ka nën ruajtje ose kontroll i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja dhe për nxjerrjen e të cilit nuk ka marrë pëlqimin e dhënësit të informacionit.

18. Në bazë të rregullës 108(1)(a) dhe (c) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë trupit gjykues kërkesë për mosnxjerrjen e informacionit, në tërësi ose pjesërisht, kur nxjerrja e këtij informacioni mund të cenojë hetimet aktuale ose hetimet e ardhshme ose kur, për ndonjë arsye tjetër, është në kundërshtim me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta. Në përputhje me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

19. Në bazë të rregullës 109(b) dhe (c) të Rregullores, ZPS-ja dhe Mbrojtja, në qoftë se zgjedhin të nxjerrin çfarëdo prove, duhet që, kur t'i nxjerrin, të dorëzojnë: (i) një përshkrim të qartë dhe përmbledhës të dokumenteve, ose kategorive të dokumenteve, që i janë dhënë palës kundërshtare; dhe (ii) kategorizimin e informacionit të nxjerrë në përputhje me akuzat e Aktakuzës së Konfirmuar, duke iu referuar veprave penale konkrete që përbëjnë bazën e tyre, elementet kontekstuale të veprave penale, veprimet e pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provat që do të paraqitën nga ZPS-ja.

20. Në përputhje me rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të urdhërojë ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar të paraqesë dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve që ZPS-ja synon të thërrasë në gjyq, si dhe listën e provave materiale të propozuara që synon të paraqesë në gjykim.

21. Në përputhje me rregullën 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit nga ZPS-ja të listës paraprake, listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale të propozuara, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të ftojë Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të paraqesë dosjen paraprake, e cila duhet të përmbajë: (i) një përshkrim të përgjithshëm të llojit të mbrojtjes së të akuzuarit; (ii) akuzat dhe pikat që i akuzuari i kundërshton, duke përmendur paragrafët konkretë në dosjen paraprake të ZPS-së dhe arsyet e kundërshtimit të të akuzuarit ndaj tyre; (iii) listën e dëshmitarëve të mundshëm që Mbrojtja synon të thërrasë në gjykim, çka nuk përjashton ndryshimet e mëvonshme që mund t'i bëhen listës ose parashtrimit të këtyre ndryshimeve. Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të kërkojë nga Mbrojtja që, brenda një afati të përcaktuar, ta njoftojë ZPS-në dhe Trupin Gjykues mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale.

22. Në bazë të rregullës 104(5) të Rregullores, brenda një afati të caktuar nga paneli dhe jo më vonë se 15 ditë përpara se të nisë të paraqesë provat e veta, Mbrojtja: (i) e lejon ZPS-në që të këqyrë dhe të bëjë kopje të çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie

dhe sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Mbrojtjes, të cilat Mbrojtja synon t'i përdorë si prova në gjykim; (ii) i jep ZPS-së të gjitha deklaratat, në rast se ka, të të gjithë dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim; dhe (iii) i jep ZPS-së të gjitha provat materiale që Mbrojtja synon të paraqesë në gjykim.

23. Në bazë të rregullave 106, 107(1), dhe 111(1) të Rregullores, disa kategori materialesh janë, në parim, të përjashtuara nga nxjerrja e informacionit, në varësi të Rregullores dhe në qoftë se paneli nuk urdhëron ndryshe. Këto materiale përfshijnë: (i) raportet, memorandumet dhe dokumentet e tjera të brendshme të përgatitura nga ZPS-ja (përfshirë Task Forcën Hetimore Speciale), Mbrojtja dhe Mbrojtja e Viktimave, përfshirë edhe ndihmësit dhe përfaqësuesit e tyre (rregulla 106 e Rregullores); (ii) materialin që i është dhënë ZPS-së në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja (rregulla 107(1) e Rregullores); dhe (iii) komunikimet e privileguara përkufizuar në rregullën 111(1) të Rregullores.

III. DISKUTIM

A. PARIMET PËR NXJERRJEN E PROVAVE

1. Hyrje

24. Korniza ligjore e DHS-së përcakton disa hapa proceduralë që duhet të ndërmerren nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe palët, në periudhën ndërmjet paraqitjes së parë të të akuzuarit dhe dorëzimit të dosjes së çështjes Trupit Gjykues, në pajtim me rregullën 98 të Rregullores. Një ndër këta hapa kritikë, është përcaktimi i një sistemi për shkëmbimin e provave midis palëve dhe vënia në dijeni e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Miratimi i një sistemi që mundëson efikasitetin e procesit të nxjerrjes së informacionit është themelor për Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të arrijë baraspeshim midis detyrës së tij për të mbrojtur interesa të caktuara, përfshirë

dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe personave të tjerë të rrezikuar, dhe detyrimin për të garantuar të drejtat e të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit.¹¹

2. Roli i palëve dhe i Zyrës Administrative

25. Nxjerrja e provave, dhe detyrimet përkatëse të palëve sipas Rregullores, është proces që kryhet midis ZPS-së dhe Mbrojtjes. Ky proces duhet të organizohet dhe ndihmohet nga Zyra Administrative, që vepron si kanal komunikimi midis palëve dhe panelit,¹² përmes programit elektronik për këtë qëllim, siç përcaktohet në rregullat 98(1)(b) dhe 109(a) të Rregullores.¹³ Palët i përmbahen Udhëzimit të Zyrës Administrative për Ngarkimin e të Dhënave në Sistemin Elektronik *Legal Workflow* gjatë nxjerrjes së provave në mënyrë elektronike.¹⁴

26. Në pajtim me nenin 34(1) të Ligjit dhe rregullën 24(1) dhe (2) të Rregullores, Administratori administron dokumentimin e plotë dhe të saktë të proceseve gjyqësore dhe ruan të gjitha provat dhe materialet e tjera të paraqitura gjatë proceseve gjyqësore, në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë vendim dhe vendimet e ardhshme për

¹¹ Shih KSC-BC-2023-10, F00076/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of the Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To) ("Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), 24 tetor 2023, para. 39; KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#) (Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To) ("Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala"), 30 prill 2021, publik, para. 28. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-117-Red3, Pre-Trial Chamber II, [Redacted First Decision on the Prosecutor's Request for Redactions and Related Requests](#), 3 July 2014, para. 17, dhe referencat aty.

¹² Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 40; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 29. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-31-tENG, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Evidence Disclosure Protocol and Other Related Matters](#) ("Al Hassan Disclosure Decision"), 16 May 2018, para. 36; *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-203, Pre-Trial Chamber II, [Decision Setting the Regime for Evidence Disclosure and Other Related Matters](#) ("Ongwen Disclosure Decision"), 27 February 2015, para. 10.

¹³ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 40; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 29.

¹⁴ KSC-BD-18, Administratorja, Udhëzim për Ngarkimin e të Dhënave në Legal Workflow, 28 gusht 2019.

këtë çështje. Ky dokumentacion duhet të jetë në dispozicion të palëve dhe pjesëmarrësve, sipas rastit, në varësi të kufizimeve të domosdoshme në lidhje me mbrojtjen dhe nivelin e konfidencialitetit, siç parashihet në nenet 23 dhe 58 të Ligjit, si dhe rregullat 80, 82, 105, 106, 107 dhe 108 të Rregullores, ose sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Në lidhje me këtë aspekt, kur nxjerrin prova, palët përcaktojnë nivelin e përshtatshëm të klasifikimit për secilën provë dhe i regjistrojnë provat si publike, përveçse kur ka arsye që t'i klasifikojnë ndryshe, në pajtim me rregullën 83(1) të Rregullores.¹⁵

3. Komunikimi i provave Gjykatëses së Procedurës Paraprake

27. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se ajo ka detyrën të marrë të gjitha masat për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim, siç kërkohet nga nenet 39(1) dhe (13) të Ligjit dhe rregulla 95(2) e Rregullores, përfshirë përgatitjen e një raporti për trupin gjykues mbi nxjerrjen e materialeve, siç parashikohet në rregullën 95(2)(b) të Rregullores. Në mënyrë që të përmbushet kjo detyrë, të gjitha provat e shkëmbyera mes palëve i komunikohen Gjykatëses së Procedurës Paraprake, pavarësisht nëse ato do të përdoren në gjykim. Ky komunikim gjithashtu ndihmon Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të sigurojë se nxjerrja e provave po kryhet në kushte të përshtatshme.¹⁶

28. Për rrjedhojë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të ketë qasje në këto prova të nxjerra: (a) të gjitha provat e ZPS-së në mbështetje të Aktakuzës së Konfirmuar;

¹⁵ Shih Transkriptin e konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 133, rreshtat 21-24. Shih gjithashtu [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 41; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 30. Shih, për ngjashmëri, ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-64-Red, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of "Decision on Disclosure and Related Matters"](#), ("Yekatom Disclosure Decision") 23 January 2019, para. 17.

¹⁶ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 42; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 31. Shih, për ngjashmëri, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 12; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 14.

(b) të gjitha deklaratat e dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim (rregulla 102(1)(b)(i) të Rregullores); (c) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet apo transkriptet që Prokurorja e Specializuar synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 102(1)(b)(ii) të Rregullores); (d) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 102(1)(b)(iii) të Rregullores); (e) të gjitha provat që vlerësohen nga Mbrojtja si juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit (rregulla 102(3) të Rregullores); (f) të gjitha provat shfajësuese që ZPS-ja i ruan, kontrollon ose ka dijeni për to, (rregulla 103 e Rregullores); (g) të gjitha provat që Mbrojtja mund t'i paraqesë për të vërtetuar një alibi ose arsye që përjashton përgjegjësinë penale, përfshirë emrat dhe të dhënat aktuale të dëshmitarëve, dhe çfarëdo prove tjetër në të cilën të akuzuarit synojnë të mbështeten për të vërtetuar këtë alibi ose arsye (rregulla 104(1)(a) dhe (b) e Rregullores); (h) të gjitha provat që Mbrojtja i ka në ruajtje ose nën kontroll, që mund të këqyren nga ZPS-ja, dhe që Mbrojtja synon t'i përdorë në gjykim (rregulla 104(5)(a) e Rregullores); (i) të gjitha deklaratat, në rast se ka, të dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim ose synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 104(5)(b) e Rregullores); dhe (j) të gjitha provat materiale që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 104(5)(c) e Rregullores).¹⁷

4. Afatet për nxjerrjen e materialeve

29. Sipas kornizës ligjore të DHS-së, nxjerrja e disa kategorive të materialeve është objekt i afateve të përcaktuara në Rregullore, ndërsa për kategoritë e tjera të materialit, përcaktimi i afateve të përshtatshme për nxjerrje të materialit i lihet Gjykatësës së

¹⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 43; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 32.

Procedurës Paraprake, duke pasur parasysh veçantitë e çështjes, vëllimin dhe veçoritë e provave dhe parashtrimet e palëve.¹⁸

30. Megjithëse ky vendim përcakton kalendarin për nxjerrjen e provave të kategorive të ndryshme, datat e caktuara aty sugjerojnë vetëm afatin minimal për dhënien e njoftimit. Kur është e mundur, pala që bën nxjerrjen e materialit duhet të përpiqet ta nxjerrë materialin përpara afateve të përcaktuara, për të mundësuar përgatitjen e duhur nga pala që merr materialin.¹⁹ Në rast të nxjerrjes së materialeve pas afateve të përcaktuara në këtë vendim ose sipas urdhrit të Gjykatës së të Procedurës Paraprake, pala që nxjerr materialin i drejton një kërkesë Gjykatës së të Procedurës Paraprake së bashku me arsyet për vonesën në nxjerrjen e materialit.²⁰

5. Plotësia dhe relevanca e provave të nxjerra

31. Secila palë siguron që provat e nxjerra të jenë të plota. Provat që janë nxjerrë padashur në formë jo të plotë mund të nxirren përsëri brenda afatit që parashihet në Rregullore, ose sipas urdhrit të Gjykatës së të Procedurës Paraprake.²¹

32. Palët gjithashtu sigurojnë që paketat e materialeve të nxjerra të jenë të plota dhe të lidhura në mënyrën e duhur me dëshmitarin(ët) përkatës. Në këtë aspekt, të gjitha dokumentet dhe materialet e përmendura në deklaratën e një dëshmitari konkret (provat materiale shoqëruese) nxirren së bashku me deklaratën përkatëse, në të njëjtën

¹⁸ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 44; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 33.

¹⁹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 45; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 34. Ngjashëm, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 13; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 20-21.

²⁰ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 45; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 34.

²¹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 46; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 35.

paketë materiale.²² Gjithashtu, kur provat kanë lidhje me një dëshmitar konkret, kjo lidhje përcaktohet duke përfshirë pseudonimin e dëshmitarit në fushën e meta të dhënave për secilën provë përkatëse në sistemin elektronik *Legal Workflow*.²³

33. ZPS-ja dhe Mbrojtja, në rast se dëshiron, nxjerrin vetëm provat me relevancë të mirëfilltë që mbështesin pretendime për fakte konkrete që plotësojnë kriteret ligjore të nevojshme, e jo sa më shumë prova, për t'i mundësuar palës marrëse të fokusojë përgatitjen e saj.²⁴

B. AFATET PËR NXJERRJEN E PROVAVE

1. Rregulla 102(1)(a): materialet mbështetëse të Aktakuzës

34. Rregulla 102(1)(a) e Rregullores trajton nxjerrjen e materialit në të cilin mbështetet ZPS-ja për të argumentuar Aktakuzën e Konfirmuar, përfshirë deklaratat e marra nga të akuzuarit. Ky material duhet të nxirret sa më parë që është e mundshme, po së paku brenda 30 ditësh pas paraqitjes së parë të të akuzuarit.²⁵

35. Në këtë çështje, ZPS-ja parashtrohet se: (i) janë gjithsej 185 materiale që duhet të nxirren sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores, përfshirë përkthimet dhe një deklaratë

²² Shih [Januzi et al Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 47; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 36. Shih përkatësisht [Annex 1](#) (Shtojca 1) e Urdhrit për Parashtrime, pika 3(e); Parashtrimet e ZPS-së, para. 28; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 167, rreshtat 7-11.

²³ Shih [Januzi et al Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të tjerët*), para. 47; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 36.

²⁴ Shih Transkriptin e konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 133, rreshtat 18-20; [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 48; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 37. Shih përkatësisht parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt dhe ZPS-së në konferencën mbi ecurinë e çështjes; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 143, rreshtat 7-16; f. 144, rreshtat 14-16. Ngjashëm, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 18; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 25; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 20.

²⁵ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 49; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 38.

të marrë nga z. Kilaj; (ii) nga këto 185 materiale gjithsej, 123 nuk kanë nevojë për redaktime dhe mund të nxirren menjëherë për Mbrojtjen; dhe (iii) 62 materialet e tjera kanë nevojë për redaktime standarde të kufizuara dhe mund të nxirren pas daljes së këtij vendimi.²⁶

36. Mbrojtja e Smakajt kërkon që materiali i rregullës 102(1)(a) të nxirret menjëherë.²⁷ Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Kilajt, Mbrojtja e Fazliut dhe Mbrojtja e Kuçit nuk kanë bërë parashtrime konkrete lidhur me materialet e rregullës 102(1)(a), përveçse kanë kërkuar disa sqarime.²⁸

37. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, ajo urdhëroi ZPS-në të nxirrte menjëherë materialin e rregullës 102(1)(a) që nuk kishte nevojë për redaktime.²⁹ Materialet e tjera që kanë nevojë për redaktime (standarde) do të nxirren pas lëshimit të këtij vendimi dhe nxjerrja e të gjitha materialeve të rregullës 102(1)(a) do të përfundojë jo më vonë se **të martën, 7 janar 2025**, siç parashikohet në rregullën në fjalë. Pavarësisht këtij afati, Gjykatësja e Procedurës Paraprake udhëzon ZPS-në të nxjerrë materialin e rregullës 102(1)(a) në mënyrë të vazhdueshme.

2. Rregulla 102(1)(b): Materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim

38. Rregulla 102(1)(b) e Rregullores trajton nxjerrjen e çfarëdo materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim, të cilin ZPS-ja nuk e ka përdorur si material mbështetës për aktakuzën që ka paraqitur për konfirmim. Ky material duhet të nxirret brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake dhe sido që të jetë, jo më

²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-17; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 156, rreshti 14 deri te f. 157, rreshti 10; f. 158, rreshtat 8-19.

²⁷ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 139, rreshtat 3-7.

²⁸ *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt, para. 21.

²⁹ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 162, rreshtat 3-13. Më 17 dhjetor 2024, pas konferencës mbi ecurinë e çështjes, ZPS-ja nxori paketën e materialeve të rregullës 102(1)(a); Paketa 6 e Materialeve të Nxjerra.

vonë se 30 ditë para nisjes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja, në përputhje me rregullën 124 të Rregullores.³⁰

39. Afati për nxjerrjen e këtij materiali mund të varet nga faktorë si: (i) sasia dhe lloji i materialit që do të nxirret; (ii) kur është mbledhur materiali nga ZPS-ja; (iii) nevoja për të kryer veprime hetimore (përfshirë marrjen e lejeve të nevojshme nga dhënësit e informacionit) para nxjerrjes së këtij materiali; (iv) përfundimi i ekzaminimeve mjekoligjore të kryera nga palë të treta; (v) shqyrtimi i materialit të privilegjuar nga një palë e tretë e pavarur; (vi) nevoja për të përkthyer këtë material ose pjesë të tij, sidomos deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar; dhe (vii) nevoja për të zbatuar masa mbrojtëse, përfshirë redaktimin e informacionit.³¹

40. Në qoftë se ZPS-ja dëshiron të nxjerrë deklarata shtesë të dëshmitarëve që synon t'i thërrasë të dëshmojnë në gjykim, por nuk e ka bërë një gjë të tillë gjatë afatit të caktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, kjo nxjerrje e vonuar duhet të plotësojë kriteret e rregullës 102(1), (2), dhe (4) të Rregullores, përfshirë përkthimin. Mbrojtja mund t'i drejtohet Gjykatësës së Procedurës Paraprake kur ka arsye për mospajtim për nxjerrjen e vonuar të materialeve.³²

41. ZPS-ja parashtron se: (i) është e përgatitur të fillojë nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b), në mënyrë progresive, duke filluar më 20 dhjetor 2024, por nuk është në gjendje të llogarisë se kur do të përfundojë nxjerrjen e tij, sepse disa hapa hetimorë janë ende në kryerje e sipër; (ii) në çdo rast, do ta nxjerrë materialin e

³⁰ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 52; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 41.

³¹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 53; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 42.

³² Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 54; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 43.

rregullës 102(1)(b) jo më vonë se 30 ditë para se të hapë çështjen; (iii) materiali përfshin kopje dhe të dhëna forenzike të telefonave celularë, audioincizime, transkripte të materialeve audio/video, lista thirrjesh telefonike dhe të dhëna të thirrjeve, raporte ekspertësh, dokumente dhe materiale të tjera që mund të sigurohen ende, përfshirë deklaratat të dëshmitarëve, të dhëna zyrtare të marra nga objekti i paraburgimit i Dhomave të Specializuara, si dhe materiale fizike; (iv) ky material mund të ketë nevojë për redaktime të kufizuara; dhe (v) ZPS-ja do të përpiqet të nxjerrë të gjitha provat materiale shoqëruese të deklaratës së dëshmitarit së bashku me deklaratën dhe të njëjtën gjë do të bëjë për çdo përkthim, për aq kohë sa kjo nuk shkakton vonesa të papërligjura.³³

42. Mbrojtja e Thaçit vlerëson marrjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe të provave materiale shoqëruese në të njëjtën kohë dhe nuk paraqet vërejtje të tjera.³⁴ Mbrojtja e Smakajt parashtron se çdo material i rregullës 102(1)(b) që është tashmë në posedim të ZPS-së dhe që nuk ka nevojë për redaktime, duhet të nxirret menjëherë për Mbrojtjen dhe jo në mënyrë progresive.³⁵ Mbrojtja e Kilajt parashtron po ashtu se materiali i rregullës 102(1)(b) duhet të nxirret sapo të jetë i disponueshëm. Ajo shton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të caktojë një afat për nxjerrjen e këtij materiali shumë përpara afatit të caktuar sipas rregullës 102(a)(b) të Rregullores (*d.m.th.* 30 ditë para fillimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja), për t'u siguruar që i akuzuari të ketë kohën dhe kushtet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.³⁶

³³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18-28; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 165, rreshti 16 deri te f. 167, rreshti 3; f. 170, rreshtat 1-6.

³⁴ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 167, rreshtat 7-11.

³⁵ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 139, rreshtat 8-18; f. 167, rreshti 14 deri te 168, rreshti 4.

³⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt, para. 22-23; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 168, rreshti 23 deri te f. 169, rreshti 13.

Mbrojtja e Fazliut kërkon të marrë çdo përkthim në shqip në të njëjtën kohë me versionet origjinale, kurse Mbrojtja e Kuçit nuk bën parashtrime specifike.³⁷

43. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, ajo udhëzoi ZPS-në të fillonte sa më shpejt që të ishte e mundur nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b) që nuk ka nevojë për redaktime. Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi gjithashtu se në këtë vendim do të vendosej një afat për nxjerrjen e materialit të mbetur sipas rregullës 102(1)(b).³⁸

44. Kur vendos afatin për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b), Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kushton vëmendje në veçanti: (i) parashtrimet të ZPS-së se është e përgatitur për të filluar nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b) që ka në posedim menjëherë dhe në mënyrë progresive;³⁹ (ii) nevojës për t'u siguruar që të akuzuarit të kenë kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen;⁴⁰ dhe (iii) nevojës për të siguruar përgatitjen e shpejtë për gjykim. Në të njëjtën kohë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban gjithashtu parasysh se: (i) disa veprime hetimore janë ende duke u kryer, gjë që mund të sjellë prova shtesë dhe përfundimi i tyre nuk është tërësisht nën kontrollin e ZPS-së;⁴¹ (ii) disa prova janë duke iu nënshtruar analizës forenzike, ndërkohë që prova të tjera mund të jetë e nevojshme të rishikohen nga një palë e tretë e pavarur dhe që të dyja janë jashtë kontrollit të ZPS-së; (iii) transkriptimi dhe përkthimi i disa materialeve në audio është ende në proces;⁴² dhe (iv) materiali i rregullës 102(1)(b) mund të ketë nevojë për redaktime, ndonëse të kufizuara.⁴³

³⁷ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 168, rreshtat 7-20.

³⁸ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 170, rreshtat 8-16.

³⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 19, 27.

⁴⁰ Neni 21(4)(c) i Ligjit.

⁴¹ *Shih* Parashtrimet e ZPS-së, para. 3-6, 11-12, 20; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 165, rreshtat 16-25.

⁴² Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

⁴³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 25.

45. Për këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e konsideron të përshtatshme vendosjen e afateve progresive për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b). Në fazën e parë, ZPS-ja do të nxjerrë materialin e rregullës 102(1)(b) që e ka aktualisht në posedim. Konkretisht, ZPS-ja: (i) do të nxjerrë të gjithë materialin e rregullës 102(1)(b) që nuk ka nevojë për redaktime, ose që ka nevojë vetëm për redaktime standarde, jo më vonë se **të hënën, 17 shkurt 2025**;⁴⁴ (ii) do të dorëzojë çdo kërkesë për masa mbrojtëse për materialin e mbetur të rregullës 102(1)(b) që ka aktualisht në posedim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se **të hënën, 17 shkurt 2025**. Mbrojtja mund të përgjigjet, në rast se dëshiron, deri **të hënën, 24 shkurt 2025**. Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk do të marrë në shqyrtim kundërpërgjigje; dhe (iii) do të nxjerrë materialin e rregullës 102(1)(b) që ka nevojë për masa mbrojtëse jo më vonë se **të hënën, 17 mars 2025**.

46. Gjithashtu, ZPS-ja duhet të dorëzojë, jo më vonë se **të hënën, 17 mars 2025**, parashtrime të përditësuara lidhur me: (i) ecurinë e hetimeve; (ii) provat shtesë të mbledhura, në rast se ka (përfshirë numrin dhe llojin e materialeve, nevojën për redaktime (standarde dhe jostandarde); (iii) kohën e përafërt të përfundimit të veprimeve hetimore në proces; (iv) nxjerrjen e materialeve të tjera të rregullës 102(1)(b) në posedim të ZPS-së, nevojën për redaktime (standarde dhe jostandarde) dhe kur mund të paraqitet kërkesë për masa mbrojtëse; (v) ecurinë e përkthimeve, sipas rastit, dhe kur mund të nxirret materiali në fjalë për Mbrojtjen; dhe (vi) parashikimin se kur mund të përfundojë nxjerrja e materialit të rregullës 102(1)(b). Pas marrjes së parashtrimeve të ZPS-së, në qoftë se do të jetë e nevojshme, Gjykatësja

⁴⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja parashikon të jetë në gjendje të japë njoftimin e parë sipas rregullës 102(3) deri më 17 shkurt 2025. Gjykatësja e Procedurës Paraprake kupton, në mënyrë të nënkuptuar, se deri në atë datë, ZPS-ja do të ketë identifikuar edhe materialin e rregullës 102(1)(b) që ka aktualisht në posedim, duke qenë se njoftimi sipas rregullës 102(3) përfshin materiale dhe prova që kanë lidhje me lëndën që nuk janë nxjerrë sipas rregullave 102(1)(a)-(b) dhe 103 të Rregullores; *shih* Parashtrimet e ZPS-së, para. 30, 32.

e Procedurës Paraprake do të caktojë një afat tjetër përfundimtar për nxjerrjen e plotë të materialit të rregullës 102(1)(b).

47. Për të përmbushur detyrimin për nxjerrjen e materialeve, ZPS-ja duhet që, në të njëjtën paketë materialesh, bashkë me deklaratën e dëshmitarit të nxjerrë edhe të gjitha provat materiale shoqëruese që lidhen me atë deklaratë, siç përcaktohet në paragrafin 32 më lart. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson pozitivisht zotimin e ZPS-së për të nxjerrë deklaratat e dëshmitarëve dhe përkthimeve të tyre në të njëjtën paketë.⁴⁵

3. Rregulla 102(3): Provat juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të marra nga të akuzuarit ose që i përkasin atyre

48. Materiali i rregullës 102(3) përfshin provat që konsiderohen juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të cilat i ka ZPS-ja në ruajtje ose kontroll, ose që i janë marrë apo i përkisnin të akuzuarve, përfshirë dokumente, fotografi dhe sende të tjera të prekshme.⁴⁶

49. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se rregulla 102(3) e Rregullores përcakton një procedurë që përfshin hapat në vijim: (i) dhënien e njoftimit të hollësishëm Mbrojtjes nga ana e ZPS-së për çdo material dhe provë që ka në zotërim; (ii) kërkesat nga Mbrojtja për nxjerrjen ose këqyrjen e materialeve në ruajtje ose kontroll të ZPS-së që konsiderohen juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, që u janë marrë të akuzuarve ose u përkasin atyre; dhe (iii) kundërshtimet e ngritura nga ZPS-ja në lidhje me rëndësinë materiale të materialit të kërkuar nga Mbrojtja.⁴⁷

⁴⁵ Shih po ashtu [Annex 1](#) (Shtojcën 1) të Urdhrit për Parashtrime, pika 3(e); Parashtrimet e ZPS-së, para. 28; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 168, rreshtat 7-15; f. 169, rreshtat 19-23.

⁴⁶ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 59; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 46.

⁴⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 60; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 47; KSC-BC-2020-07, IA005/F00008/RED, Gjykata e Apelit, [Public Redacted Version of Decision on the Appeals Against Disclosure Decision](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit

50. Si hap i parë, ZPS-ja duhet të përgatisë dhe të nxjerrë pa vonesë një njoftim të hollësishëm për të gjithë materialin dhe provat në zotërim të saj, siç përcaktohet në rregullën 102(3) të Rregullores. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se kjo kërkesë ka të bëjë me çdo provë dhe material në zotërim të ZPS-së.⁴⁸ Njoftimi i hollësishëm duhet të përfshijë jo vetëm informacionin që ZPS-ja vlerëson se mund të jetë juridikisht thelbësor për përgatitjen e Mbrojtjes, por edhe *çdo* material dhe provë në zotërim të ZPS-së që nuk është nxjerrë sipas rregullave 102(1)(a)-(b) dhe 103 të Rregullores dhe që ka lidhje me *çështjen*.⁴⁹

51. Siç përcaktohet shprehimisht në rregullën 102(3) të Rregullores, argumentet për rëndësinë materiale të këtyre provave materiale bëhen nga Mbrojtja. Shprehja *juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes* interpretohet gjerësisht dhe u referohet të gjitha dokumenteve dhe sendeve që janë relevante për përgatitjen e mbrojtjes, në ushtrim të të drejtave të të akuzuarve sipas Ligjit dhe Rregullores.⁵⁰ Ajo çka është

për Nxjerrje të Informacionit) ("Vendimi i Apelit mbi Nxjerrjen e Informacionit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*"), 29 korrik 2021, publik, para. 38.

⁴⁸ Shih [Gucati and Haradinaj Appeals Decision on Disclosure](#) (Vendimi i Apelit mbi Nxjerrjen e Informacionit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*), para. 54 ("Trupi Gjykues rikujton se Prokuroria nuk mund të nxjerrë atë çka nuk e ka në posedim dhe nuk është e detyruar të ndërmarrë hetime, të kryejë analiza apo të krijojë produkte pune që nuk janë në ruajtjen, kontrollin apo posedimin e saj, ose për të cilat faktikisht nuk ka në dijeni.").

⁴⁹ Shih Transkriptin e konferencës mbi ecurinë e çështjes, f. 172, rreshtat 7-11; [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 61; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 48; [Gucati and Haradinaj Appeals Decision on Disclosure](#) (Vendimi i Apelit mbi Nxjerrjen e Informacionit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*), para. 38, 40, 42, 44, 46.

⁵⁰ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 62; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 49; [Gucati and Haradinaj Appeals Decision on Disclosure](#) (Vendimi i Apelit mbi Nxjerrjen e Informacionit në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*), para. 41. Shih për ngjashmëri, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/AC/AR126.4, F0004, Appeals Chamber, [Public Redacted Version of 19 September Decision on Appeal by Counsel for Mr Oneissi Against Pre-Trial Judge's "Decision on Issues Related to the Inspection Room and Call Data Records"](#) ("2 October 2013 Decision"), 2 October 2013, para. 21, dhe referencat aty; ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1433 (OA 11), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr. Lubanga Dyilo against the Oral Decision of Trial Chamber I of 18 January 2008](#) ("11 July 2008 Judgment"), 11 July 2008, para. 77-78; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-1330 (OA 3), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Bosco Ntaganda against the "Decision on Defence requests](#)

juridikisht thelbësore në këtë kontekst jo detyrimisht duhet të kufizohet me kuadrin kohor që mbulon Aktakuza e Konfirmuar, apo të trajtojë vetëm aspekte që kundërshtojnë drejtpërdrejt argumentet e ZPS-së ose mbështesin një linjë argumenti të Mbrojtjes.⁵¹ Përgatitja e Mbrojtjes është gjithashtu një koncept i gjerë dhe nuk duhet të kufizohet vetëm në çka lidhet drejtpërdrejt me provat shfajësuese ose inkriminuese⁵² apo me argumentet e ZPS-së.⁵³ Në dallim nga këto, materialet që janë thjesht personale, të parëndësishme, hipotetike ose hamendësuese, që nuk kanë lidhje me akuzat e ngritura kundër të akuzuarit ose që kanë vetëm marrëdhënie logjike abstrakte me aspektet, mund të konsiderohen si juridikisht jothelbësore për përgatitjen e mbrojtjes.⁵⁴ Në qoftë se një material konsiderohet juridikisht thelbësor (dhe kjo nuk kundërshtohet), atëherë materiali nxirret në tërësi dhe jo vetëm pjesë të tij.⁵⁵

52. Mbrojtja gjithashtu mund të kërkojë nxjerrjen ose këqyrjen e materialit që nuk është përfshirë në njoftimin e ZPS-së, por që Mbrojtja pretendon se është juridikisht thelbësor për përgatitjen e saj. Sidoqoftë, në një rast të tillë, Mbrojtja duhet: (i) të japë

seeking disclosure orders and a declaration of Prosecution obligation to record contacts with witnesses", 20 May 2016, para. 23, dhe referencat aty.

⁵¹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 62; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 49; [Gucati and Haradinaj Appeals Decision on Disclosure](#) (Vendimi i Apelit mbi Nxjerrjen e Informacionit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj), para. 41. Shih po ashtu, STL, [2 October 2013 Decision](#), para. 22, dhe referencat aty.

⁵² Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 62; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 49. Ngjashëm, ICC, [11 July 2008 Judgment](#), para. 77.

⁵³ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 62; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 49. Ngjashëm, STL, [2 October 2013 Decision](#), para. 22, dhe referencat aty.

⁵⁴ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 62; [Gucati and Haradinaj Appeals Decision on Disclosure](#) (Vendimi i Apelit mbi Nxjerrjen e Informacionit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj), para. 41. Shih gjithashtu Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 143, rreshtat 7-16; f. 144, rreshtat 14-16.

⁵⁵ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 62.

parametra të përshtatshëm për specifikimin e çdo dokumenti të kërkuar, për t'i mundësuar ZPS-së që të identifikojë dokumentin e kërkuar; dhe (ii) të sqarojë rëndësinë materiale të dokumenteve të kërkuara për përgatitjen e Mbrojtjes. Mbrojtja nuk mund të mbështetet thjesht në përshkrime të përgjithshme ose në pretendime të pabazuara për informacionin e kërkuar dhe duhet të shmangë paraqitjen e kërkesave në formën e frazave të përgjithshme.⁵⁶

53. Së fundi, ZPS-ja mund t'i drejtohet Gjykatësës së Procedurës Paraprake kur ka arsye për të kundërshtuar rëndësinë materiale që i jep Mbrojtja informacionit. Në qoftë se ZPS-ja nuk pajtohet me këto kërkesa të Mbrojtjes, mund të kundërshtojë parametrat e specifikimit si dhe rëndësinë materiale të dokumenteve të kërkuara.⁵⁷ Pas kundërshtimit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson rëndësinë materiale të materialit në tërësi dhe jo informacione të veçanta që përmban apo pjesë të veçanta të tij. Në qoftë se konstatohet se një material nuk është juridikisht thelbësor për përgatitjen e mbrojtjes, nuk nxirret asnjë pjesë e atij materiali, as ndonjë informacion i veçantë që përmban ai.⁵⁸

54. ZPS-ja parashtrohet se: (i) nuk është në gjendje të japë vlerësim të saktë të volumit të materialit të rregullës 102(3), sepse kjo është një kategori materialeve të mbetura që ndikohet në shkallë të madhe prej provave që synohet të paraqiten në gjykim ose që mund të jenë shfajësuese dhe që nxirren sipas rregullave 102(1)(a), (b) dhe 103 të Rregullores; (ii) megjithatë, ajo mund t'i japë Mbrojtjes një njoftim fillestar sipas rregullës 102(3) deri më 17 shkurt 2025; (iii) është e mundshme që të duhet edhe një

⁵⁶ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 63; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 50.

⁵⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 64; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 51.

⁵⁸ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 64.

tjetër njoftim më pas; dhe (iv) një pjesë e materialit sipas rregullës 102(3) mund të ketë nevojë për redaktim.⁵⁹

55. Mbrojtja e Thaçit fton ZPS-në që në njoftimin sipas rregullës 102(3), për secilin material të japë në mënyrë sistematike kodet e dëshmitarëve përkatës ose emrin e të akuzuarit për materiale të sekuestruara nga ai i akuzuar.⁶⁰ Mbrojtja e Smakajt parashtron se materiali i rregullës 102(3) duhet të nxirret për Mbrojtjen menjëherë dhe jo progresivisht.⁶¹ Mbrojtja e Fazliut, Mbrojtja e Kuçit dhe Mbrojtja e Kilajt nuk kanë bërë parashtrime specifike në lidhje me materialin e rregullës 102(3).⁶²

56. Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e konsideron të përshtatshme të caktojë **të hënën, 17 shkurt 2025**, si afat për nxjerrjen prej ZPS-së të njoftimit të hollësishëm për provat sipas rregullës 102(3) të Rregullores. Më pas, Mbrojtja do t'i bëjë të ditur ZPS-së se në cilat nga dokumentet e renditura në njoftimin e hollësishëm kërkon të ketë qasje, nëpërmjet nxjerrjes ose këqyrjes së tyre. Mbrojtja këtë duhet ta bëjë të ditur deri **të hënën, 3 mars 2025**, ose më herët. Në bazë të këtij njoftimi, jo më vonë **të hënën, 10 mars 2025**, ose **brenda një (1) jave** nga njoftimi i Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme, ZPS-ja duhet të nxjerrë materialin e përzgjedhur që nuk ka nevojë për redakte ose që ka nevojë vetëm për redakte standarde ose t'i japë Mbrojtjes qasje në të. Në qoftë se Mbrojtja do të kërkojë qasje në material dhe nxjerrje të tij sipas rregullës 102(3) që ka nevojë për redakte, ZPS-ja duhet t'i bëjë menjëherë Gjykatësës së Procedurës Paraprake një kërkesë për masa mbrojtëse, jo më vonë se **të hënën, 17 mars 2025**, ose **brenda katërmëdhjetë (14) ditësh** nga njoftimi i Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme. Në qoftë se ZPS-ja dëshiron të kundërshtojë rëndësinë e materiale të provave në njoftimin e Mbrojtjes, ajo

⁵⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 30-33; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 173, rreshtat 1-19; f. 174, rreshti 23 deri te f. 175, rreshti 14.

⁶⁰ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 173, rreshti 23 deri te f. 174, rreshti 2.

⁶¹ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 139, rreshtat 19-22; f. 174, rreshtat 5-10.

⁶² Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 174, rreshtat 12-19.

duhet t'i drejtohet Trupit Gjykses **brenda katërmëdhjetë (14) ditësh** nga njoftimi i Mbrojtjes.

57. Gjatë gjithë fazës paraprake të procedurës gjyqësore, nga data e dorëzimit të njoftimit të mëparshëm, ZPS-ja do të dorëzojë çdo dy muaj njoftime të hollësishme shitesë për materialet sipas rregullës 102(3) të Rregullores, në qoftë se nuk urdhërohet ndryshe. Afati i përcaktuar më lart do të zbatohet *mutatis mutandis*, që do të thotë: (i) Mbrojtja duhet t'i bëjë të ditur ZPS-së, **brenda katërmëdhjetë (14) ditësh** nga marrja e njoftimit se në cilat nga materialet e renditura në njoftim dëshiron të ketë qasje; (ii) ZPS-ja duhet të nxjerrë ose t'i japë qasje Mbrojtjes në materialet e përzgjedhura që nuk kanë nevojë për redaktime ose që kanë nevojë vetëm për redaktime standarde **brenda një (1) jave** nga njoftimi i Mbrojtjes; dhe (iii) ZPS-ja duhet t'i dorëzojë Gjykatës së Procedurës Paraprake çdo kërkesë për masa mbrojtëse dhe kundërshtim në lidhje me rëndësinë materiale, në qoftë se dëshiron ta bëjë këtë, **brenda katërmëdhjetë (14) ditësh** nga njoftimi i Mbrojtjes.

58. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren me miratim propozimin e bërë nga Mbrojtja e Thaçit,⁶³ i cili do t'i mundësonte Mbrojtjes të shqyrtonte njoftimet sipas rregullës 102(3) dhe do të përshpejtonte procesin. Rrjedhimisht, ZPS-ja urdhërohet që në njoftimet e saj sipas rregullës 102(3) të përcaktojë kodet e dëshmitarëve përkatës, aty ku është e përshtatshme, dhe emrin e të akuzuarit, të cilit i janë marrë ose i përkisnin materialet.

4. Rregulla 103: Provat shfajësuese

59. Materiali i rregullës 103 (provat shfajësuese) përfshin çdo informacion që është nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së, për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të ZPS-së. Kushti që ZPS-ja t'i nxjerrë

⁶³ Shih më lart para. 55.

provat shfajësuese *menjëherë*, *sapo* të jenë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të saj, përcakton detyrimin e përhershëm të ZPS-së që t'i japë një material të tillë Mbrojtjes, përveçse kur arsye të përligjshme nuk lejojnë nxjerrjen e menjëhershme të informacionit, siç është nevoja për redaktime.⁶⁴ I takon ZPS-së që të bëjë vlerësimin fillestar nëse një informacion i caktuar është ose nuk është shfajësues, gjë që duhet të bëhet me ndershmëri.⁶⁵ Në fillim të fazës paraprake, kushti është që ZPS-ja të fillojë *menjëherë* shqyrtimin dhe t'i nxjerrë *menjëherë* provat, kur vlerëson se ato mund të përmbajnë informacion shfajësues.⁶⁶ Mungesa e një afati të prerë për provat shfajësuese nuk nënkupton shtyrjen e procesit të nxjerrjes së provave për një fazë të mëvonshme.⁶⁷

60. ZPS-ja parashtron se ka ndër mend të nxjerrë së shpejti një paketë materiale të rregullës 103 dhe se do të vazhdojë të shqyrtojë materialet që ka dhe, *sapo* të identifikojë të tjera, do t'i nxjerrë *menjëherë*, në varësi të nevojës për redaktime.⁶⁸

⁶⁴ Shih Transkriptin e Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes, f. 176, rreshtat 9-16; [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 68; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 54; KSC-BC-2020-06, F00936/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Thaçi and Krasniqi Defence Motions Seeking Remedies for Non-Compliance with Disclosure Obligations](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes së Thaçit dhe Krasniqit që Kërkojnë Mjet Juridik për Mospërbushje të Detyrimeve të Nxjerrjes së Materialit) ("Vendimi për Mospërbushjen e Detyrimeve në Çështjen *Thaçi dhe të Tjerët*"), 26 gusht 2022, publik, para. 28. Ngjashëm, ICTR, *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Decision on Motions Relating to the Appellant Hassan Ngeze's and the Prosecution's Request for Leave to Present Additional Evidence of Witness ABC1 and EB](#) ("27 November 2006 Decision"), 27 November 2006, para. 11, dhe referencat aty. Shih gjithashtu, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 16; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 18.

⁶⁵ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 68; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 54. Ngjashëm, ICTR, [27 November 2006 Decision](#), para. 11, dhe referencat aty.

⁶⁶ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 68; [Thaçi et al. Disclosure Non-Compliance Decision](#) (Vendimi për Mospërbushjen e Detyrimeve në Çështjen *Thaçi dhe të Tjerët*), para. 28.

⁶⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 68; [Thaçi et al. Disclosure Non-Compliance Decision](#) (Vendimi për Mospërbushjen e Detyrimeve në Çështjen *Thaçi dhe të Tjerët*), para. 28.

⁶⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 34-35; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 177, rreshtat 4-8.

61. Mbrojtja e Smakajt i kërkon Gjykatëses së Procedurës Paraprake të urdhërojë ZPS-në që ta nxjerrë paketën e parë të materialeve të rregullës 103 deri në fund të javës dhe parashtron se provat shfajësuese duhet të nxirren menjëherë.⁶⁹ Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Fazliut, Mbrojtja e Kuçit dhe Mbrojtja e Kilajt nuk kanë bërë parashtrime konkrete në lidhje me materialin e rregullës 103.

62. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se paketa e parë e materialit të rregullës 103 është nxjerrë për Mbrojtjen më 18 dhjetor 2024.⁷⁰ Rrjedhimisht, kjo kërkesë e Mbrojtjes së Smakajt është e tejkaluar.

63. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e gjykon të arsyeshme të urdhërojë ZPS-në të nxjerrë të gjithë materialin e rregullës 103 menjëherë pasi të ketë zbuluar ekzistencën e tij dhe në vijimësi, veçanërisht në qoftë se materialit nuk është nevoja t'i bëhen redaktime. Në rastet kur materialet kanë nevojë për redaktime, ZPS-ja duhet t'i drejtohet Gjykatëses së Procedurës Paraprake sa më parë për të marrë vendim në lidhje me këtë aspekt, për të mundësuar nxjerrjen e menjëhershme të atij materiali për Mbrojtjen.⁷¹

5. Rregulla 107: Materiali i mbrojtur

64. Rregulla 107 e Rregullores, së bashku me nenin 58 të Ligjit, trajtojnë nxjerrjen e materialit që i është dhënë ZPS-së në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja. Një material i tillë, në parim, nuk është objekt i nxjerrjes, përveçse me pëlqimin e dhënësit të informacionit.⁷²

⁶⁹ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 139, rreshtat 22-24 ; f. 177, rreshtat 21-23.

⁷⁰ Paketa 7 e Materialit të Nxjerrë.

⁷¹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 70; [Shala Disclosure Decision](#), (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 56.

⁷² Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 71; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 57.

65. Kur materiali i mbrojtur është objekt i nxjerrjes sipas rregullës 102 dhe/ose 103 të Rregullores, ZPS-ja i bën kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* panelit për t'u liruar plotësisht ose pjesërisht nga detyrimi për nxjerrjen e materialit në fjalë. ZPS-ja gjithashtu mund të kërkojë masa kompensuese në bazë të rregullës 108(2) të Rregullores.⁷³

66. ZPS-ja parashtron se nuk ka nevojë të merret pëlqimi i dhënësit të informacionit për nxjerrjen e materialit të rregullës 107 të cilin ZPS-ja aktualisht parashikon ta paraqesë si provë në gjykim dhe shton se, në rast se situata ndryshon, do ta informojë Gjykatësen e Procedurës Paraprake menjëherë.⁷⁴ Mbrojtja nuk bën parashtrime në lidhje me këtë pikë.⁷⁵

67. Duke marrë parasysh zotimin e ZPS-së,⁷⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që ta vërë menjëherë në dijeni për çdo problem lidhur me materialin që preket nga rregulla 107 e Rregullores.

C. NXJERRJA E PROVAVE NGA MBROJTJA

68. Parimet dhe procedurat e përcaktuara në vendimin aktual vlejné njëlloj për Mbrojtjen, në varësi të detyrimeve përkatëse të Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se detyrimet e Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 104 të Rregullores, aktivizohen vetëm në qoftë se Mbrojtja vendos të paraqesë prova dhe, në çdo rast, vetëm pasi ZPS-ja të ketë paraqitur dosjen

⁷³ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 72; [Shala Disclosure Decision](#), (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 58.

⁷⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 36-37.

⁷⁵ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 179, rreshtat 5-7 .

⁷⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 37.

paraprake dhe listën e dëshmitarëve që do të thirren në gjykim dhe provat materiale të propozuara, në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores.⁷⁷

69. Rrjedhimisht, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake dhe pas paraqitjes prej ZPS-së të dosjes paraprake dhe listës së dëshmitarëve e provave materiale të propozuara, ekipet e Mbrojtjes do të ftohen të paraqesin dosjet paraprake dhe të bëjnë të ditur informacionin që kërkohet të jepet sipas rregullës 95(5) të Rregullores, pa cenuar të drejtën e Mbrojtjes për të bërë të ditur synimin për të paraqitur mbrojtje përmes alibisë, ose çfarëdolloj arsyeje tjetër për përjashtimin e përgjegjësisë penale, në cilëndo datë më të hershme.⁷⁸

70. Duke pasur parasysh se procesi i nxjerrjes së informacionit sapo ka filluar, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk do të marrë vendime të tjera. Afatet që rregullojnë paraqitjen e dosjes paraprake dhe listën e dëshmitarëve dhe provave materiale të ZPS-së, të cilat pastaj përcaktojnë edhe afatet për paraqitjen e dosjes paraprake të Mbrojtjes dhe nxjerrjen e provave të tyre, në qoftë se kanë, gjithashtu do të përcaktohen në një fazë të mëvonshme.

D. PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE PROVAVE

71. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet të sigurojë që provat, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve, të nxirren në gjuhën angleze, gjuha e punës së procesit, siç është përcaktuar në nenin 20 të Ligjit dhe rregullën 8(3) të Rregullores.⁷⁹

⁷⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 75; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 61.

⁷⁸ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 76; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 62.

⁷⁹ KSC-BC-2023-12, F00076, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Working Language](#) (Vendimi për Gjuhën e Punës), 11 dhjetor 2024, publik, para. 28(a). Shih gjithashtu [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 78; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 64.

72. Në anën tjetër, neni 21(4)(a) i Ligjit përcakton se i akuzuari duhet të informohet në një gjuhë që kupton për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij, në këtë rast, në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, kjo e drejtë nuk nënkupton të drejtën e pakufizuar dhe absolute për të marrë të gjitha provat, dokumentet dhe parashtrimet e protokolluara në gjuhën e të akuzuarit. Përkthimi i të gjithë dosjes së çështjes, përfshirë provat, do të cenonte të drejtën për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, të përcaktuar në nenin 21(4)(d) të Ligjit.⁸⁰ Rrjedhimisht, duhet të arrihet një ekuilibër midis këtyre të drejtave konkurruese në mënyrë që procesi të jetë njëkohësisht i drejtë dhe i shpejtë.⁸¹

73. Si rezultat i sa më lart, Rregullorja përcakton se të gjitha deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, duhet të jenë në dispozicion në gjuhën që kupton dhe flet i akuzuari, siç kërkohet shprehimisht në rregullën 102(1) të Rregullores.⁸² Të gjitha provat e tjera paraqiten në gjuhën angleze, në pajtim me vendimin për gjuhën e punës, përveçse kur Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëron ndryshe.⁸³

74. Ndiurma falas e përkthyesit me gojë së bashku me këshillat profesionale të mbrojtësit, siç parashihet në nenin 21(4)(c) dhe (g) të Ligjit, do t'i ndihmojnë të akuzuarit për të kuptuar provat dhe parashtrimet në lidhje me to që nuk janë në gjuhën shqipe.⁸⁴ Gjithashtu, Mbrojtja mund t'i kërkojë ZPS-së dhënien e përkthimeve

⁸⁰ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 79; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 65. Ngjashëm, ICC, [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 31-32; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-307, Pre-Trial Chamber III, [Decision on the Defence's Request Related to Language Issues in the Proceedings](#), 4 dhjetor 2008, para. 15.

⁸¹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 79; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 65.

⁸² Shih gjithashtu Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 169, rreshtat 19-23.

⁸³ [Decision on Working Language](#); shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 80; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 66.

⁸⁴ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 81; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*),

në shqip të provave ose të pjesëve të veçanta të tyre, përveç deklaratave të dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, në rast se ZPS-ja i ka tashmë në posedim këto përkthime.⁸⁵ Kur bën kërkesa të tilla, Mbrojtja duhet të tregojë arsyet pse është thelbësore që këto prova të merren në gjuhën shqipe dhe pse i akuzuari nuk është në gjendje të vlerësojë përmbajtjen e tyre me ndihmën e përkthyesit dhe këshillën e mbrojtësit. Në rast mospajtimesh mes Mbrojtjes dhe ZPS-së në këtë aspekt, Mbrojtja duhet t'i drejtohet sa më shpejt që të jetë e mundur Gjykatësës së Procedurës Paraprake.⁸⁶

E. PROCEDURA PËR NXJERRJEN E PROVAVE

75. Materiali shoqërues që parashihet në rregullën 109(b) dhe (c) të Rregullores është konceptuar që t'i mundësojë palës marrëse që të jetë në pozitat më të mira të mundshme për t'u njohur dhe për ta shqyrtuar materialin e nxjerrë me qëllim që të fokusohet te përgatitja dhe, më përgjithësisht, përmirësimi i shpejtësisë dhe drejtësisë së procesit.⁸⁷

76. Rregulla 109(c) e Rregullores përshkruan në terma të përgjithshëm kategoritë që mund t'i caktohen materialit provues kur ngarkohet në sistemin elektronik *Legal*

para. 67. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-56-Red, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of "Decision on Language Proficiency of Alfred Yekatom for the Purposes of the Proceedings"](#), 11 January 2019, para. 18; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 33.

⁸⁵ Shih gjithashtu [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 81; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 67. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Yekatom dhe Ngaïssona*, ICC-01/04-01/18-163, Pre-Trial Chamber II, [Second Decision on Disclosure and Related Matters](#), 4 April 2019, para. 38; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 23.

⁸⁶ Shih gjithashtu [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 81; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 67.

⁸⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 82; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 68. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-47, Pre-Trial Chamber II, [Decision Setting the Regime for Evidence Disclosure and Other Related Matters](#), 12 April 2013, para. 31-32; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-55, Pre-Trial Chamber III, [Decision on the Evidence Disclosure System and Setting a Timetable for Disclosure between the Parties](#), 31 July 2008, para. 72-73.

Workflow dhe nxirret për palën marrëse.⁸⁸ Kategoritë që ka sistemi elektronik *Legal Workflow* janë: “të akuzuarit”; “sjellja e pretenduar e të akuzuarve”; “elementet kontekstuale të veprave penale”; “vendndodhja”; dhe “veprat penale bazë” (“Kategoria Standarde” dhe “Kategoritë Standarde”). Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se Kategoritë Standarde “veprat penale bazë” dhe “elementet kontekstuale të veprave penale” nuk janë relevante për çështjen aktuale. Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake udhëzon ZPS-në që të krijojë një Kategori Standarde të re të titulluar “veprat penale”.⁸⁹

77. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se palët bënë disa vëzhgime për nënkategoritë dhe formatin specifik të tabelës sipas rregullës 109(c) për këtë çështje, por se ato po vazhdojnë t’i diskutojnë disa detaje *inter partes*.⁹⁰

78. Në parim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se nënkategorizimi specifik për çështjen është i nevojshëm që të garantojë kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.⁹¹ Në lidhje me këtë, duke marrë parasysh parashtrimet e palëve në konferencën për ecurinë e çështjes⁹² dhe në pritje të përfundimit të diskutimeve *inter partes*, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konsideron të dobishëm përdorimin e këtyre nënkategorive specifike për çështjen në sistemin elektronik *Legal Workflow*: “Pika 1”, “Pika 2”, “Pika 3”, etj. dhe “të gjitha” (në Kategorinë Standarde “veprat penale”); (ii) “kryerja”, “nxitja”, “ndihma”, “marrëveshja” dhe “të gjitha” (në Kategorinë Standarde “sjellja e pretenduar e të akuzuarve”); dhe (iii) “Thaçi”,

⁸⁸ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 86; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 71.

⁸⁹ Ngjashëm [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 86.

⁹⁰ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 185, rreshti 6 deri te f. 18, rreshti 10.

⁹¹ Shih [Order for Submissions](#) (Urdhri për Parashtrime), para. 20; [Annex 1](#) (Shtojca 1) e Urdhrit për Parashtrime, pika 8(a) dhe (b); shih gjithashtu [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 87.

⁹² Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 185, rreshtat 6-8; f. 186, rreshtat 9-13.

“Smakaj”, “Fazliu”, “Kilaj”, “Kuçi” dhe “të gjithë” (në Kategorinë Standarde “të akuzuarit”).

79. Palët mund të veprojnë mbi bazën e nënkategorive të sipërpërmendura. Në qoftë se palët, gjatë diskutimeve *inter partes*, pajtohen për përdorimin e nënkategorive specifike të mëtejshme në sistemin elektronik *Legal Workflow*,⁹³ Gjykatësja e Procedurës Paraprake i udhëzon që t’i raportojnë asaj menjëherë, siç përcaktohet më poshtë.

80. Në lidhje me tabelën sipas rregullës 109(c), Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se palët janë të angazhuara aktualisht në diskutime *inter partes* lidhur me formatin e kësaj tabele.⁹⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren me miratim propozimin e bërë nga Mbrojtja e Thaçit⁹⁵ dhe urdhëron palët të bëjnë një parashtrim të përbashkët mbi rezultatet e diskutimeve të tyre lidhur me modelin e tabelës së nxjerrjes së materialeve jo më vonë se **të premten, 31 janar 2025**.

81. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se ZPS-ja parashtron se tabela sipas rregullës 109(c) duhet të kufizohet vetëm në materialet e rregullës 102(1)(b), duke qenë se përmbledhja sipas rregullës 86(3) ofron tashmë një analizë të gjerë të materialit të rregullës 102(1)(a).⁹⁶ Mbrojtja parapëlqen të marrë një tabelë të përmbledhur që i referohet si materialeve të rregullës 102(1)(a), ashtu edhe materialit të rregullës 102(1)(b).⁹⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake i ka parasysh parashtrimet e Mbrojtjes. Megjithatë, në interes të zhvillimit efikas dhe të shpejtë të procesit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e çmon të përshtatshme që, tabela e ZPS-së sipas rregullës 109(c) dhe çdo shtesë e saj, duhet të ketë lidhje vetëm me materialin e rregullës 102(1)(b) dhe të rregullës 102(2), sepse siç u theksua me të drejtë nga ZPS-

⁹³ *Shih* Parashtrimet e ZPS-së, para. 39; Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 10.

⁹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 42-43; Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 11; Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes, f. 185, rreshti 10 deri te f. 188, rreshti 6.

⁹⁵ Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes, f. 186, rreshtat 7-13.

⁹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 42.

⁹⁷ Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes, f. 186, rreshti 15 deri te f. 188, rreshti 6.

ja, analiza e materialit të rregullës 102(1)(a) përfshihet në përmbledhjen sipas rregullës 86(3)(b). Ndërsa tabela e Mbrojtjes sipas rregullës 109(c) duhet të lidhet me materialin e rregullës 104(1), (5) dhe (6).⁹⁸

82. Sa i përket kohës së paraqitjes së tabelës sipas Rregullës 109(c), Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se kjo çështje është me kompleksitet të kufizuar faktik dhe juridik, dhe ka të bëjë me pretendime për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, me fushëveprim të kufizuar kohor dhe gjeografik. Gjykatësja e Procedurës Paraprake merr gjithashtu parasysh se është më e preferueshme që progresi i nxjerrjes së materialeve të mos ndërpritet, dhe se mënyra më e shpejtë dhe efikase e veprimit është që tabela sipas rregullës 109(c) të hartohet afër kohës së paraqitjes së dosjeve paraprake. Për këtë arsye, dhe duke marrë parasysh parashtrimet përputhëse të palëve,⁹⁹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake udhëzon palët të dorëzojnë tabelat sipas rregullës 109(c) **brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh** nga dita e dorëzimit të dosjeve paraprake përkatëse të tyre.¹⁰⁰

⁹⁸ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 90; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 73; KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#) (Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Mustafa) ("Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Mustafa"), 9 tetor 2020, publik, para. 71; KSC-BC-2020-07, F00121, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Submissions on Rule 109\(c\) Categorisation](#) (Vendim mbi Parashtrimet në lidhje me Kategorizimin sipas Rregullës 109(c)), ("Vendimi në lidhje me Kategorizimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj"), 11 shkurt 2021, publik, para. 15-19; KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Categorisation of Evidence Under Rule 109\(c\) and Related Matters](#) (Vendim për Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të lidhura me To), 12 mars 2021, publik, para. 9-10, 25.

⁹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 41; Parashtrimet e Thaçit, para. 12; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 186, rreshtat 21-23.

¹⁰⁰ Shih gjithashtu [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 91; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 74; [Gucati and Haradinaj Categorisation Decision](#) (Vendimi në lidhje me Kategorizimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj), para. 21.

F. KUFIZIMET PËR NXJERRJEN E INFORMACIONIT

1. Parimet e përgjithshme

83. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se nxjerrja e plotë e të gjitha materialeve dhe provave relevante është parim, ndërsa mosnxjerrja e informacionit është përjashtim.¹⁰¹ Siç sugjeron leximi i kombinuar i nenit 21(6) të Ligjit dhe rregullave 80(1) dhe 108(1) të Rregullores, çfarëdo kufizimi ndaj nxjerrjes së plotë të informacionit duhet të jetë absolutisht i nevojshëm për mbrojtjen e: (i) sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët në DHS, me kusht që këto masa të përputhen me të drejtat e të akuzuarve; (ii) hetimeve aktuale ose të ardhshme; dhe (iii) interesit publik dhe të drejtave të palëve të treta. Në këtë kontekst, kujtojmë se është e lejueshme që Mbrojtjes të mos i nxirren informacione të caktuara para gjykimit.¹⁰²

84. Redaktimet që synojnë mbrojtjen e hetimeve aktuale ose të ardhshme ose të interesit publik dhe të drejtave të palëve të treta, zbatohen vetëm me kërkesë të Prokurorit të Specializuar ose të Mbrojtjes, të paraqitura konfidencialisht dhe *ex parte*.¹⁰³ Redaktimet që synojnë mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse

¹⁰¹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 92; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 75. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-568 (OA3), Appeals Chamber, [Judgment on the Prosecutor's appeal against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "Decision Establishing General Principles Governing Applications to Restrict Disclosure pursuant to Rule 81 \(2\) and \(4\) of the Rules of Procedure and Evidence"](#) ("13 October 2006 Judgment"), 13 October 2006, para. 1, 39; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-475 (OA), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of the Prosecutor against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements"](#) ("13 May 2008 Judgment"), 13 May 2008, para. 70.

¹⁰² Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 92; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 75. Ngjashëm, ICC, [13 May 2008 Judgment](#), para. 68.

¹⁰³ Rregulla 108(1) dhe (6) e Rregullores.

në procese gjyqësore dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët, zbatohen me kërkesë të cilësdo prej palëve, të paraqitur konfidencialisht dhe *ex parte*, ose *proprio motu*.¹⁰⁴

85. Së fundi, nevoja për redakte duhet të vlerësohet rast pas rasti.¹⁰⁵ Në përcaktimin e sistemit të redaktimit që do të zbatohet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të balancojë interesat konkurruese, duke siguruar në të njëjtën kohë që procesi të jetë i drejtë dhe i shpejtë.¹⁰⁶

2. Standardi ligjor

86. Gjatë vlerësimit nëse një informacion i caktuar mund të mos nxirret për palën marrëse, duhet të përcaktohet nëse:¹⁰⁷

- (i) nxjerrja e informacionit në fjalë për palën marrëse, në ndryshim nga nxjerrja për publikun, paraqet rrezik objektivisht të arsyetueshëm për personin ose interesin e mbrojtur;
- (ii) masa mbrojtëse është rreptësisht e domosdoshme.¹⁰⁸ Si rrjedhojë, në qoftë se janë të mjaftueshme dhe të realizueshme masa

¹⁰⁴ Rregulla 80(1) dhe (3) e Rregullores.

¹⁰⁵ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 94; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 77. Ngjashëm, ICC, [13 October 2006 Judgment](#), para. 36; [13 May 2008 Judgment](#), para. 2, 59, 66.

¹⁰⁶ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 94; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 77.

¹⁰⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të tjerët), para. 95; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 78; [Mustafa Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Mustafa), para. 76. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-773 (OA5), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr. Thomas Lubanga Dyilo against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Requests and Amended requests for Redactions under Rule 81"](#), 14 December 2006, para. 21, 33-34; [13 May 2008 Judgment](#), para. 95-99; ECtHR, *Rowe and Davis v. United Kingdom*, no. 2890/95, [Judgment](#), 16 February 2000, para. 61; *Botmeh and Alami v. United Kingdom*, no. 15187/03, [Judgment](#), 7 June 2007, para. 37.

¹⁰⁸ Neni 21(6) i Ligjit.

mbrojtëse më pak kufizuese, duhet të zgjidhen masa mbrojtëse të tilla; dhe

- (iii) masa mbrojtëse është proporcionale kundrejt dëmit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjykimit të drejtë.¹⁰⁹

3. Sistemi i redaktimit

87. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, me përjashtim të Mbrojtjes së Smakajt,¹¹⁰ palët mbështesin përdorimin e sistemit të redaktimit të përdorur në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës* (“Çështja Januzi dhe të tjerët”).¹¹¹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka parasysh shqetësimet e ngritura nga Mbrojtja e Smakajt dhe Mbrojtja e Kilajt¹¹² dhe vlerëson se këto shqetësime trajtohen nga procedura e përshkruar në paragrafin 93 më poshtë.

88. Rrjedhimisht, dhe me qëllim përshpejtimin e procesit dhe krijimin e një sistemi efikas, të parashikueshëm dhe përputhës për redakte, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është e përshtatshme të miratojë sistemin e redaktimit në çështjen *Januzi dhe të tjerët*, me modifikimet e përshkruara në paragrafët 98-99 më poshtë. Me miratimin e këtij sistemi, palët kanë udhëzime të mjaftueshme për zbatimin e redakteve, në qoftë se do të ketë, para nxjerrjes së provave që zotërojnë.¹¹³

89. Sipas këtij sistemi, provat mund të nxirren nga cilado palë, me redakte të bëra drejtpërdrejt për kategori të paracaktuara të informacionit (“**redakte standarde**”)

¹⁰⁹ Rregulla 80(1) e Rregullores.

¹¹⁰ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 181, rreshtat 6-12.

¹¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 38; Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 9; Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt, para. 24; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 177, rreshti 14 deri te f. 178, rreshti 12, që i referohet [Januzi et al Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të tjerët*), para. 96-109.

¹¹² Shih Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt, para. 24; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 181, rreshtat 6-12; f. 182, rreshtat 4-24.

¹¹³ Shih [Januzi et al Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të tjerët*), para. 97; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 80.

pa autorizim gjyqësor paraprak.¹¹⁴ Në këtë rast, pala që bën nxjerrjen e informacionit nuk është e detyruar që të paraqesë kërkesë të veçantë. Pala marrëse ka të drejtë të kundërshtojë cilindo redaktim të zbatuar pas nxjerrjes së provave.¹¹⁵

90. Për redaktimet që janë jashtë kategorive të paracaktuara të përmendura më lart (“**redaktimet jostandarde**”), pala që nxjerr informacionin duhet t’i paraqesë kërkesë të veçantë Gjykatësit të Procedurës Paraprake për autorizim për të kufizuar nxjerrjen e informacionit, sipas procedurës së përcaktuar më poshtë.¹¹⁶

91. Në rastin e redaktimeve standarde dhe jostandarde, informacioni që nuk nxirret mund të nxihet, hiqet, ose të zëvendësohet me tekstin “[REDAKTUAR]”. Gjithashtu, pala që bën nxjerrjen e informacionit, bën të ditur llojin e redaktimit në kutinë e redaktimit ose në çfarëdo vendi të përshtatshëm duke përdorur një kod specifik si në listën më poshtë, përveçse kur një shënim i tillë do të binte ndesh me qëllimin e redaktimit. Ky format do ta lejojë lexuesin që ta njohë menjëherë llojin e informacionit që është redaktuar ose hequr dhe arsyetimin përkatës. Në rast se informacioni i redaktuar i takon më shumë se një kategori, duhet të shënohen të gjitha kodet përkatëse.¹¹⁷

92. Kur nxirret informacioni me redakte, pala që bën nxjerrjen e informacionit i cakton pseudonim të veçantë çdo personi, identiteti i të cilit është redaktuar sipas kategorive A.3 dhe A.4, siç përcaktohet më poshtë, që shoqërojnë kodin ose kodet përkatëse të redaktimit. Qëllimi i pseudonimeve të tilla është që t’i mundësojë lexuesit të materialit të redaktuar të kuptojë nëse është fjala për të njëjtin person të përmendur në prova materiale të ndryshme. Pala që bën nxjerrjen e materialit nuk ka nevojë të

¹¹⁴ Shih më poshtë para. 100-101.

¹¹⁵ Shih më poshtë para. 93.

¹¹⁶ Shih më poshtë para. 102.

¹¹⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të tjerët”), para. 100; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 83.

japë kodin e kategorisë dhe/ose pseudonimin kur kjo bie ndesh me qëllimin e redaktimit, por bën të qartë se cilat kode/pseudonime janë hequr për këtë arsye.¹¹⁸

93. Pala marrëse mund të kundërshtojë çdo redaktim konkret për të cilin mendon se është i papërligjur, ose në rast se mendon se një redaktim konkret duhet të hiqet si rezultat i rrethanave të ndryshuara. Për këtë qëllim ajo i drejtohet drejtpërdrejt palës që bën nxjerrjen e informacionit. Palët konsultohen në mirëbesim për ta sqaruar këtë problem. Në rast se palët nuk janë në gjendje të pajtohen, pala marrëse mund t'i bëjë kërkesë pa vonesë të panevojshme Gjykatësës së Procedurës Paraprake që të lëshojë vendim, duke e detyruar palën që nxjerr informacionin që të arsyetojë redaktimin në fjalë. Në këtë rast, pala që bën nxjerrjen e informacionit dorëzon përgjigjen e saj në dokumentacionin e çështjes **brenda pesë (5) ditësh** nga njoftimi i kundërshtimit, përveçse kur vendoset ndryshe nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.¹¹⁹

94. Pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet të **monitrojë** nevojën e vazhdueshme për redakte dhe rinxjerr prova me më pak redakte pa kërkuar paraprakisht leje nga paneli përkatës menjëherë pasi arsyet që justifikojnë redaktimet nuk ekzistojnë më, ose, në rast se është e zbatueshme, bën kërkesë sipas rregullës 81(1) dhe (2) të Rregullores, në rast se redaktimet duhet të vazhdojnë të kenë efekt në procedurat e mëpasshme. Redaktimet mund të **hiqen** edhe pas: (i) marrëveshjes midis palëve se nuk ekziston më rrezik objektivisht i identifikueshëm për personin ose interesin në fjalë; ose (ii) urdhrit nga paneli kompetent. Në qoftë se informacioni i redaktuar i takon më shumë se një kategorie, redaktimet duhet të hiqen pas përfundimit të të gjitha afateve përkatëse. Në qoftë se pala që nxjerr informacionin

¹¹⁸ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 101; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 84.

¹¹⁹ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe të Tjerët*), para. 102; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*), para. 85.

dëshiron t'i mbajë redaktimet edhe pas kalimit të afatit për heqjen e tyre, ajo duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.¹²⁰

95. Për të verifikuar, në bazë të kompetencës së saj diskrecionale, vlefshmërinë e redaktimeve të zbatuara nga pala që nxjerr informacionin dhe, në rast se është e nevojshme, për të urdhëruar *proprio motu* palën që nxjerr informacionin që të heqë redaktimet, pjesërisht ose plotësisht, pasi t'i ketë dhënë mundësi asaj të paraqesë komentet e veta, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konsideron se është e përshtatshme që t'i marrë provat në version të paredaktuar në kohën që palës marrëse i jepet version i redaktuar i tyre.¹²¹ Kjo i mundëson Gjykatësës së Procedurës Paraprake të **verifikojë**, në përputhje me rregullat 80(1) dhe 108(1) të Rregullores, masën dhe vlefshmërinë e çdo redaktimi, duke shtuar kështu një nivel shqyrtimi shtesë në dobi të palës marrëse. Gjithashtu, kjo i mundëson Gjykatësës së Procedurës Paraprake që të reagojë shpejt në rast se ka kundërshtime në lidhje me redaktimet e zbatuara, sipas rastit. Kjo nuk ndikon në faktin që pala që nxjerr informacionin duhet të mbështetet vetëm në formën e redaktuar të provave, siç i janë dhënë palës marrëse.¹²²

96. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të rregullës 81(1)(a) të Rregullores, **pasi urdhërohen**, masat mbrojtëse **mbeten në fuqi** në çfarëdo procesi të mëpasshëm, përveçse dhe deri kur të ndryshohen. Rrjedhimisht, në çështjen aktuale, nuk është e nevojshme që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të

¹²⁰ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 103; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 86.

¹²¹ Vetëm Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të ketë qasje në dokumentin e mëparshëm në sistemin elektronik të menaxhimit. Ngjashëm, [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 104; [Shala Disclosure Decision](#), para. 87; ICC, [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 32; [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 28.

¹²² Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 104; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 87.

urdhërojë vazhdimin e zbatimit të masave mbrojtëse, të urdhëruara në procese të tjera të DHS-së. Kjo ndodh automatikisht sipas rregullës 81(1)(a) të Rregullores.¹²³

4. Redaktimet standarde

97. Kategoritë për redaktime standarde janë të përcaktuara qartë dhe të rrënjosura në praktikat e gjykatave të tjera ¹²⁴ dhe janë miratuar në çështje të tjera të gjykuara në DHS.¹²⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake miraton kategoritë e mëposhtme të redaktimeve standarde dhe arsyet e dhëna për to duke pasur parasysh standardin e shtjelluar më lart.¹²⁶ Sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, nxjerrja për palën marrëse e informacionit të kategorizuar më poshtë zakonisht nënkupton rrezik objektivisht të identifikueshëm për interesat përkatës dhe kërkon miratimin e masave mbrojtëse që janë absolutisht të domosdoshme, gjithmonë duke mbajtur parasysh të drejtat e të akuzuarve dhe drejtësinë e gjykimit.¹²⁷

98. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren propozimin e ZPS-së për të miratuar (në masën që kjo është e nevojshme) një kategori të re redaktimesh standarde (në bllok). ZPS-ja parashtrohet se kjo kategori do të zbatohet, për shembull, për transkriptet e dëshmive që vijnë nga procese të tjera, kur këto transkripte përmbajnë

¹²³ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 105.

¹²⁴ Për shembull, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 25-26; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 29.

¹²⁵ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 107; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 89; [Mustafa Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Mustafa), para. 86; KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#) (Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Thaçi dhe të Tjerët”), 23 nëntor 2020, publik, para. 95; KSC-BC-2020-07, F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#) (Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To) (“Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Gucati dhe Haradinaj”), 22 janar 2021, publik, para. 82.

¹²⁶ Shih më lart para. 86.

¹²⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 106; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 88.

dëshmitë e dy dëshmitarëve dhe vetëm njëri prej tyre është i rëndësishëm për procesin aktual. Dëshmia e dëshmitarit që nuk lidhet me çështjen do të mbulohet me redaktim në bllok.¹²⁸ Mbrojtja e kundërshton këtë propozim.¹²⁹

99. Gjykatësja e Procedurës Paraprake merr parasysh parashtrimet e Mbrojtjes, por vlerëson se, duke pasur parasysh lidhjen e natyrshme me procese të tjera në Dhomat e Specializuara, është e kuptueshme që materiali provues mund të përmbajë informacion krejt jorelevant. Duke qëndruar te shembulli i ZPS-së, dëshmia e një dëshmitari dhënë në procese të tjera, e cila nuk ka asnjë lidhje me këtë çështje, nuk do të jetë objekt i nxjerrjes së informacionit në këtë çështje. Kjo pranohet edhe nga vetë Mbrojtja e Kilajt, kur thotë se “parimisht duhet të nxirren vetëm provat relevante për çështjen”.¹³⁰ Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se kjo kategori e re redaktimesh standarde është veçanërisht e përshtatshme në rrethanat e çështjes aktuale dhe mund të nxisë nxjerrjen e shpejtë të provave përkatëse për Mbrojtjen, si dhe zhvillimin e shpejtë të procesit. Çdo shqetësim i Mbrojtjes mund të trajtohet përmes procesit të verifikimit nga ana e Gjykatësës së Procedurës Paraprake dhe faktit që Mbrojtja ka mundësinë të kundërshtojë redaktimet në bllok të zbatuara. Gjykatësja e Procedurës Paraprake e çmon të arsyeshme miratimin e kësaj kategorie të re, pavarësisht parashtrimit të ZPS-së se kjo mund të mos jetë e nevojshme, me qëllim që redaktimet në bllok të shënohen në mënyrë përkatëse, në dobi të Mbrojtjes. Për këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miraton një kategori të re redaktimesh standarde, që do të shënohet si **Kategoria “G”**, nën kategorinë “(c) (Informacion tjetër që nuk është objekt i nxjerrjes së informacionit në pajtim me Rregulloren”, siç përcaktohet më poshtë.

¹²⁸ Parashtrimet e ZPS-së, poshtëshënimi 3; Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 179, rreshti 24 deri te f. 180, rreshti 7.

¹²⁹ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 180, rreshti 17 deri te f. 182, rreshti 14; f. 183, rreshtat 4-15.

¹³⁰ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 143, rreshtat 7-9.

100. Bazuar në sa më sipër, kategoritë e informacionit që mund të redaktohet nga pala që bën nxjerrjen e informacionit pa autorizim gjyqësor paraparak janë:

(a) *Redaktimet sipas rregullës 108(1)(a) të Rregullores:*

Kategoria “A.1”: Vendndodhjet e intervistave dhe të akomodimit, në rast se nxjerrja e informacionit në lidhje me to mund të tërheqë vëmendjen në mënyrë të papërshtatshme ndaj lëvizjeve të palëve, personelit, viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të Dhomave të Specializuara, duke krijuar në këtë mënyrë rrezik objektiv për hetime aktuale apo hetime të ardhshme. Në parim, ky informacion nuk është i rëndësishëm as për palën tjetër. Redaktime të tilla hiqen kur vendi nuk përdoret më në hetimet aktuale dhe të ardhshme.

Kategoria “A.2”: Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të personelit ose kontraktuesve të palëve, Zyrës Administrative ose Dhomave të Specializuara (duke përjashtuar hetuesit), të cilët udhëtojnë shpesh në terren ose janë të vendosur atje, në rast se nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikonte këta persona dhe/ose të pengonte punën e tyre, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale dhe të ardhshme (saktësohet më tej në “A.2.1.” për përkthyesit me shkrim dhe gojë, “A.2.2.” për stenografët, “A.2.3” për ekspertët psiko-socialë, “A.2.4” për ekspertët e tjerë mjekësorë, “A.2.5.” për pjesëtarët e tjerë të personelit që hyjnë në këtë kategori, dhe “A.2.6.” për kontraktuesit e tjerë që hyjnë në këtë kategori).

Kategoria “A.3”: Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të hetuesve, duke mbajtur parasysh se palët kanë një numër të kufizuar hetuesish, nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikojë ata dhe pengojë punën e tyre në terren, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale ose të ardhshme, ose rrezikon sigurinë e dëshmitarëve ose personave të tjerë që ata intervistojnë ose kontaktojnë. Në pajtim me paragrafin 92, më lart, pala që bën nxjerrjen e informacionit e shënon pseudonimin unik të hetuesit, si dhe kodin e kategorisë (p.sh. “A.3.1.”, “A.3.2.”, “A.3.3.”, etj.).

Kategoria “A.4”: Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të ndërmjetësuesve, në rast se nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikojë këta persona dhe të pengojë punën e tyre në terren, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale ose të ardhshme, ose rrezikon sigurinë e dëshmitarëve ose personave me të cilët ata kanë kontakt. Në pajtim me paragrafin 99 më lart, pala që bën nxjerrjen e informacionit e shënon pseudonimin unik të ndërmjetësuesit, si dhe kodin e kategorisë (p.sh. “A.4.1.”, “A.4.2.”, “A.4.3.”, etj.).

Kategoria “A.5”: Të dhënat e identifikuese dhe të kontaktit të sinjalizuesve dhe burimeve, përfshirë dëshmitarët e mundshëm,¹³¹ në rast se nxjerrja e këtij

¹³¹ Dëshmitarë të mundshëm janë personat që ose janë intervistuar ose do të intervistohen nga palët. Për klasifikimin, “burimet e prokurorisë”, shih ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-

informacioni mund të çojë në frikësimin e dëshmitarëve ose në ndërhyrjet te ta, gjë që mund të dëmtojë hetimet aktuale ose të ardhshme (saktësohet më tej si "A.5.1." për sinjalizuesit dhe burimet individuale, përfshirë dëshmitarët e mundshëm, "A.5.2." për organizatat joqeveritare, "A.5.3." për organizatat ndërkombëtare, "A.5.4." për agjencitë shtetërore, "A.5.5." për institucionet akademike, "A.5.6." për kompanitë private", dhe "A.5.7." për burimet e tjera). Kur sinjalizuesi ose burimi jep material që nxirret, identiteti i tyre duhet të nxirret si burim në kontekst të asaj nxjerrjeje të informacionit, me kusht që të mos ketë probleme shtesë në lidhje me sigurinë dhe sinjalizuesi ose burimi nuk është i mbrojtur sipas nenit 35(2)(e) të Ligjit dhe rregullës 107 të Rregullores.

Kategoria "A.6": Mjetet e përdorura për komunikim me dëshmitarët, në qoftë se nxjerrja e këtij informacioni mund të komprometojë teknikat hetimore dhe vendndodhjen e dëshmitarëve. Në parim, ky informacion nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

Kategoria "A.7": Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(a) të Rregullores, në qoftë se nxjerrja e informacionit të redaktuar do të dëmtonte hetimet aktuale, ose të ardhshme.

(b) Redaktimet sipas nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullave 80(4)(a)(i)-(ii) dhe 108(1)(b)-(c) të Rregullores:

Kategoria "B.1": Të dhënat e kontaktit të dëshmitarëve, përfshirë numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat dhe postën elektronike (email), në qoftë se nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e personit në fjalë.

Kategoria "B.2": Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të anëtarëve të familjeve të dëshmitarëve, si numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat dhe posta elektronike, në qoftë se nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e tyre. Individë të tillë janë jashtëzakonisht të rrezikuar duke pasur parasysh se ata nuk janë pajtuar që të jenë pjesë e proceseve të Dhomave të Specializuara dhe mund të mos jenë në dijeni se një anëtar i familjes është dëshmitar dhe, për këto arsye, ekziston rreziku se mund të konsiderohen sikur kanë lidhje me Dhomat e Specializuara. Redaktimet e të dhënave të kontaktit duhet të jenë në vijimësi. Kur redaktimi i të dhënave identifikuese zbatohet vetëm për të mbrojtur dëshmitarin për të cilin redaktimet nuk janë më të justifikueshme, redaktimi nën këtë kategori duhet të hiqet kur të

476 (OA2), Appeals Chamber, [*Judgment on the appeal of z. Germain Katanga against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements"*](#), 14 maj 2008, para. 1-2, 46, 49. Dëshmitarët e mundshëm dallojnë nga "palët e treta të pafajshme" (shih kategorinë B.3 më poshtë ndërsa të parët janë kontaktuar ose do të kontaktohen nga palët gjatë hetimeve përkatëse në kontekst të proceseve gjyqësore të DHS-së, palët e treta të pafajshme nuk kontaktohen në kontekst të hetimeve të palëve dhe mund të mos jenë të vetëdijshëm se emri i tyre është përmendur në kontekst të hetimeve të tilla. Ky dallim mund të jetë me rëndësi për palën marrëse dhe duhet të shënohet duke përdorur kode të ndryshme.

nxirret identiteti i dëshmitarit. Kur redaktimi i të dhënave identifikuese nën këtë kategori zbatohet për sigurinë e një anëtari të familjes dhe identiteti i këtij anëtari të familjes nuk është i rëndësishëm për asnjë aspekt të njohur në këtë çështje, redaktimet e kësaj kategorie duhet të jenë në vijimësi. Për redaktimet që nuk hyjnë në rastet e lartpërmendura, pala që nxjerr informacionin duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

Kategoria "B.3": Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të individëve që janë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dëshmitarëve, por të cilët nuk janë viktimë, dëshmitarë aktualë ose të mundshëm, burime ose anëtarët e familjeve të tyre ("palët e treta të pafajshme"),¹³² përfshirë numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat, postën elektronike dhe fotografitë, në qoftë se nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e tyre. Individë të tillë nuk janë pajtuar të jenë pjesë e proceseve të Dhomave të Specializuara dhe mund të mos jenë në dijeni që emri i tyre përmendet në kontekst të këtyre proceseve dhe, për këtë arsye, janë në rrezik të shihen si dëshmitarë ose bashkëpunëtorë të mundshëm me Dhomat e Specializuara. Redaktimet e të dhënave të kontaktit nën këtë kategori duhet të jenë në vijimësi. Për individët që nuk janë relevantë për asnjë nga problemet e njohura në këtë çështje, redaktimet e të dhënave identifikuese nën këtë kategori duhet të jenë në vijimësi. Përndryshe, pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

Kategoria "B.4": Vendndodhja e dëshmitarëve të pranuar në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dhënat e vendeve që përdoren për zhvendosjen e këtyre dëshmitarëve aktualisht dhe në të ardhmen, përfshirë ato që përdoren para hyrjes në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, në qoftë se nxjerrja e këtij informacioni mund të komprometojë konfidencialitetin e këtyre vendeve, duke i rrezikuar kështu dëshmitarët e mbrojtur. Në parim, informacioni nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

Kategoria "B.5": Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(b)-(c) të Rregullores, në rast se nxjerrja e informacionit të redaktuar do të shkaktonte rrezik të rëndë për sigurinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese ose anëtarëve të familjeve ose do të ishte në kundërshtim me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta për çfarëdo arsye.

(c) Informacion tjetër që nuk është objekt i nxjerrjes së informacionit në pajtim me Rregulloren:

Kategoria "C": Produkti i punës së brendshme që përmban cildo material që është objekt i nxjerrjes së informacionit në përputhje me rregullën 106 të Rregullores. Për redakte të tilla nuk nevojitet miratimi i panelit.

Kategoria "D": Komunikimet e bëra në kontekst të marrëdhënieve profesionale midis një personi dhe mbrojtësit të specializuar të tij në përputhje me rregullën

¹³² Rregulla 80(1) e Rregullores. Ngjashëm, ICC, [13 May 2008 Judgment](#), paras 1, 40, 56.

111(1) të Rregullores. Për redakte të tilla nuk nevojitet miratimi i panelit. Këto redakte nuk mund të zbatohen për informacionin sipas rregullës 111(2)-(6) të Rregullores. Në këto raste, duhet t'i bëhet kërkesë panelit përkatës.

Kategoria "F": Redaktimet e autorizuara në procese të mëhershme sipas rregullës 81(1)(a) të Rregullores. Redakte të tilla duhet të përmbajnë numrin e çështjes dhe të vendimit përkatës.

Kategoria "G": Redakte në pjesë të materialit provues, në veçanti në transkriptet e dëshmive që e kanë burimin nga procese të tjera, kur këto transkripte përmbajnë dëshmi të disa dëshmitarëve, nga të cilët vetëm një ose disa janë relevante për çështjen në shqyrtim. Redaktimet në dëshmitë e dëshmitarëve që janë plotësisht jorelevante dhe që nuk lidhen me çështjen në shqyrtim mund të bëhen pa miratimin paraprak të Trupit Gjykses.

101. Redaktimet e kategorive A-D duhet të zbatohen, në përputhje me rregullat 106 dhe 108(1) të Rregullores, *mutatis mutandis*, edhe për informacion të barasvlershëm nga agjenci të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, përfshirë policinë dhe prokurorinë e Kosovës, TPNJ-në, KFOR-in, UNMIK-un dhe misionin EULEX-Kosova.¹³³ Kur përdoren këto redakte, duhet të përfshihet identifikuesi i agjencisë në fjalë së bashku me kodin përkatës të redaktimit.

5. Redaktimet jostandarde

102. Redaktimet jostandarde kanë të bëjnë veçanërisht me emrat e dëshmitarëve identitetet e të cilëve nuk duhet t'i bëhen të njohura palës kundërshtare para fillimit të gjykimit dhe rastet kur nuk duhet të nxirren pjesë të tëra të provave.¹³⁴ Në raste të tilla, pala që bën nxjerrjen e informacionit i paraqet kërkesë paraprakisht në kohë të mjaftueshme panelit përkatës për të mundësuar nxjerrjen në kohë të vendimit përkatës dhe më pas nxjerrjen e provave brenda afateve të përcaktuara në Rregullore

¹³³ Neni 37(1) i Ligjit.

¹³⁴ *Shih Januzi et al. Disclosure Decision* (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 108; *Shala Disclosure Decision* (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 90; *Mustafa Disclosure Decision* (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Mustafa), para. 88; *Thaçi et al. Disclosure Decision* (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Thaçi dhe të Tjerët), para. 97; *Gucati and Haradinaj Disclosure Decision* (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Guçati dhe Haradinaj), para. 83. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-224, Pre-Trial Chamber II, *Decision on issues related to disclosure and exceptions thereto*, 23 April 2015, para. 7; *Yekatom Disclosure Decision*, para. 32; *Al Hassan Disclosure Decision*, para. 33.

ose në vendimin e panelit. Në të njëjtën kohë, palës marrëse duhet t'i jepet versioni i redaktuar i kërkesës ; pala marrëse mund të përgjigjet **brenda pesë (5) ditësh** nga njoftimi i kërkesës. Gjithashtu, për t'i mundësuar Gjykatësës së Procedurës Paraprake që të marrë një vendim objektiv, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") paraqet, **brenda pesë (5) ditësh** pas njoftimit të kërkesës për mosnxjerrje të informacionit, një vlerësim të rrezikut për secilin dëshmitar në lidhje me të cilin është kërkuar mosnxjerrja e identitetit, ose, në rastin e dëshmitarëve për të cilët vlerësimi i rrezikut është paraqitur tashmë, informacion të përditësuar, në qoftë se është e nevojshme.¹³⁵ Me autorizim, të gjitha redaktimet jostandarde shënohen si **kategoria "E"**.¹³⁶

103. Redaktimet që hyjnë në këtë kategori **hiqen** pas urdhrit të panelit përkatës ose sapo pushojnë së ekzistuari arsyet që përlligjin zbatimin e tyre. Në qoftë se njëra nga palët ka ndër mend të heqë një redaktim jostandard që ka të bëjë me emrin e dëshmitarit, sepse beson se arsyet që përlligjin mosnxjerrjen e identitetit nuk ekzistojnë më, ajo palë e njofton Gjykatësen e Procedurës Paraprake dhe ZMMD-në për këtë **pesë (5) ditë para** heqjes së redaktimit në fjalë.¹³⁷

IV. VENDIM

104. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

¹³⁵ ZMMD-ja mund të dorëzojë vlerësime të rrezikut në lidhje me KSC-BC-2023-12, F00087, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesa në lidhje me To*, 16 dhjetor 2024, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, brenda afatit të caktuar për Zyrën Administrative në transkriptin e konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, f. 190, rreshtat 4-12. Për këtë qëllim, Administratorja do t'i vërë në dispozicion ZMMD-së parashtrimin e protokolluar F00087. Versioni i redaktuar konfidencial i kërkesës në fjalë iu dha Mbrojtjes më 20 dhjetor 2024, F00087/CONF/RED; Më të njëjtën ditë, Shtojca 1 u riklasifikua si konfidenciale.

¹³⁶ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 108; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 90.

¹³⁷ Shih [Januzi et al. Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe të Tjerët), para. 109; [Shala Disclosure Decision](#) (Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala), para. 91.

- a) **URDHËRON** palët dhe Administratoren që të zbatojnë parimet për nxjerrjen e provave, të shtjelluara në paragrafët 24-33 të këtij vendimi;
- b) **URDHËRON** ZPS-në që të përfundojë nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(a) të Rregullores jo më vonë se **të martën, 7 janar 2025**;
- c) **URDHËRON** ZPS-në që të përfundojë nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b) të Rregullores që është aktualisht në posedimin e saj dhe që nuk ka nevojë për redaktime, ose që ka nevojë vetëm redaktime standarde, jo më vonë se **të hënë, 17 shkurt 2025**;
- d) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë çdo kërkesë për masa mbrojtëse në lidhje me materialin e rregullës 102(1)(b) të Rregullores që ka aktualisht në posedim, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se **të hënë, 17 shkurt 2025**. Mbrojtja mund të përgjigjet, në rast se dëshiron, deri **të hënë, 24 shkurt 2025**;
- e) **URDHËRON** ZPS-në të përfundojë nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, që ka aktualisht në posedim dhe që për të cilin kërkohen masa mbrojtëse, jo më vonë se **të hënë, 17 mars 2025**;
- f) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrimet e përditësuara siç urdhërohet në paragrafin 46 të këtij vendimi, jo më vonë se **të hënë, 17 mars 2025**;
- g) **URDHËRON** ZPS-në t'i japë Mbrojtjes një njoftim të parë të hollësishëm për provat sipas rregullës 102(3) të Rregullores jo më vonë se **të hënë, 17 shkurt 2025**;
- h) **URDHËRON** Mbrojtjen që t'i bëjë të ditur ZPS-së, deri **të hënë, 3 mars 2025**, ose në çdo kohë më herët, se në cilat materiale të rregullës 102(3) të Rregullores prej atyre të renditura në njoftimin e parë të detajuar, kërkon të ketë qasje me anë të nxjerrjes ose këqyrjes së informacionit;

- i) **URDHËRON** ZPS-në që, në bazë të njoftimit/njoftimeve të Mbrojtjes sipas pikës (h) më lart, të nxjerrë ose t'i japë Mbrojtjes qasje në materialin e përzgjedhur që nuk ka nevojë për redaktime, ose që ka nevojë vetëm për redaktime standarde, jo më vonë se **të hënën, 10 mars 2025**, ose **brenda një (1) jave** nga kërkesa/kërkesat e Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme;
- j) **URDHËRON** ZPS-në që, në bazë të njoftimit/njoftimeve të Mbrojtjes sipas pikës (h) më lart, të paraqesë ndonjë kërkesë që mund të ketë për masa mbrojtëse për materialin e përzgjedhur jo më vonë se **të hënën, 17 mars 2025**, ose **brenda katërmëdhjetë (14) ditësh** nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme;
- k) **URDHËRON** ZPS-në t'i drejtohet Gjykatësës së Procedurës Paraprake **brenda katërmëdhjetë (14) ditësh** nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes sipas pikës (h) më lart, në qoftë se ka kundërshtime për rëndësinë materiale të provave;
- l) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë njoftime të hollësishme shtesë për provat sipas rregullës 102(3) të Rregullores çdo dy muaj nga dorëzimi i njoftimit të mëparshëm, përveç nëse urdhërohet ndryshe, dhe **URDHËRON** të gjitha palët të respektojnë afatet e caktuara në paragrafin 57 të këtij vendimi;
- m) **URDHËRON** ZPS-në të nxjerrë paketën/paketat e mbetura të materialit të rregullës 103 menjëherë dhe progresivisht;
- n) **URDHËRON** ZPS-në që, në qoftë se ndonjë material i rregullës 103 të Rregullores ka nevojë për redaktime, të bëjë kërkesë për masa mbrojtëse sa më parë dhe ta nxjerrë menjëherë këtë material me redaktime, në qoftë se kërkesa miratohet;

- o) **URDHËRON** ZPS-në ta njoftojë sa më shpejt Gjykatësen e Procedurës Paraprake për çfarëdo problemi në lidhje me materialin që ndikohet nga rregulla 107 e Rregullores;
- p) **URDHËRON** palët që të zbatojnë kriteret e sistemit të redaktimit të përcaktuara në paragrafët 83-103 të këtij vendimi;
- q) **URDHËRON** palët që të përdorin kategoritë standarde në fushën e meta të dhënave për çdo material të nxjerrë, si dhe nënkategoritë specifike sipas çështjes, siç përcaktohet në paragrafët 75-79 të këtij vendimi;
- r) **URDHËRON** palët të dorëzojnë një parashtrim të përbashkët mbi rezultatet e diskutimeve të tyre lidhur me ndonjë nënkategori shtesë, si dhe tabelën e rregullës 109(c) jo më vonë se **të premten, 31 janar 2025**;
- s) **URDHËRON** palët të dorëzojnë tabelat përkatëse sipas rregullës 109(c), siç përcaktohet në paragrafët 81-82 të këtij vendimi, **brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh** nga paraqitja e dosjeve paraprake përkatëse;
- t) **URDHËRON** ZMMD-në të paraqesë, **brenda pesë (5) ditësh** nga paraqitja e kërkesës nga cilado palë për mosnxjerrje informacioni, një vlerësim të rrezikut për secilin dëshmitar për të cilin është kërkuar mosnxjerrja e identitetit, siç përcaktohet në paragrafin 102 të këtij vendimi;
- u) **URDHËRON** Zyrën Administrative t'i vërë në dispozicion ZMMD-së parashtrimin e protokolluar F00087, siç specifikohet në poshtëshënimin 135 të këtij vendimi;
- v) **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publik parashtrimin e protokolluar F00082 të Mbrojtjes së Thaçit; dhe
- w) **URDHËRON** Mbrojtjen e Kilajt të kërkojë riklasifikimin, ose të dorëzojë një version të redaktuar publik të parashtrimeve të saj, F00083, jo më vonë se **të mërkurën, 15 janar 2025**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E premte, 20 dhjetor 2024

Në Hagë, Holandë.